

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

FACULTY OF LAW

STUDIME POSTDIPLOMIKE

TEMË MASTERI

“Matja gjyqsore e sanksioneve penale dhe zbatimi i masave alternative ne Republikën e Maqedonisë”

Mentor

Prof.dr.BESA ARIFI

Kandidati

AMET ISMANI

Tetovo 2019

Teza:

"Matja gjyqsore e sanskioneve penale dhe zbatimi i masave alternative në Republikën e Maqedonisë"

Теза:

"Судско мерење на кривичните санкции и примена на алтернативните мерки во Република Македонија"

Thesis:

"Court measuring of the criminal sanctions and implementation of the alternative measures in the Republic of Macedonia"

Abstrakt

Qëllimi kryesor i hulumtimit është studimi dhe analiza sa i përket matjes gjyqsore të sanksioneve penale dhe zbatimit të masave alternative.

Theks të vecant do ti kushtohet asaj se si gjykatat e bëjnë matjen gjyqsore të sanksioneve penale dhe dënimeve alternative si pjesë e sanksioneve penale, sa masat alternative janë të zbatueshme në praktikë, cilat zbatohen më së shumti, arsyeja dhe a kanë sukses masat alternative duke marrë parasyh faktin se deri në vitin 2004 kemi pas vetëm dy lloje të masave alternative: dënimi me kusht(burg) dhe vërejtja gjyqsore.

Gjatë këtij studimi do mundohem të flas për suksesin e masave alternativë e si alternativë e burgut ku për dallim nga dënimi me burg që në vete është sanksion retributivo-preventiv, masat alternative janë sanksione preventive tek të cilat elementi retributiv është i ngërthyer dhe i vendosur në funksion të kërcënimit me dënim gjë që përforcon veprimin e tyre preventiv.

Абстракт

Главната цел на ова истражување е студијата и анализата во врска со судското мерење на кривичните санкции и примена на алтернативните мерки.

Посебно значење ќе му се посвети на тоа како судовите прават судско мерење на кривичните санкции и алтернативните мерки како дел од кривичните санкции, колку алтернативните мерки се применети во пракса, кој се применуваат повеќе, целта и дали имат успех алтернативните мерки земајќи го во предвид фактот дека до 2004 година сме имале само две вида алтернативни мерки: условна осуда(затвор) и судска опомена.

Во текот на оваа студија ќе се потрудам да зборувам за успехот на алтернативните мерки како алтернатива на затворот со тоа што за разлика од затворска казна што во себе е ретрибутивна-превентивна санкција, алтернативните мерки се превентивни санкции кај кои ретрибутивниот елемент е потиснат и ставен во функција на закана со казна што го засилува нивното превентивно дејство.

Abstract

The main intention of the research is the study and analysis related to court measuring of the criminal sanctions and implementation of alternative measures.

Special importance will be devoted to how the courts make court measuring of the criminal sanctions and alternative measures as part of criminal sanctions, how much alternative measures are applicable in practice, which are applied the most, reason and do alternative measures have success knowing that until 2004 we had two alternative measures: probation(jail) and judicial remark.

During this study I will try to talk about the success of the alternative measures as an alternative of prison where in difference from prison sentence which is retributive-preventive sanction, alternative sanctions are preventive sanctions where the retributive element is suppressed and set in function of the threat with sentence the thing that reinforces their preventive action.

Falënderime/Mirënjohje

Për realizimin e këtij punimi dua të falenderoj në radhë të parë mentorin tim Prof.Dr.Besa Arifin për mbështetjen e jashtzakonshme, ndihmën, dhe inkurajimin që më ka dhënë gjatë gjithë procesit të studimit, idetë dhe lehtësimet në lidhje me punimin tim në fushën e së drejtës penale ndihma e së cilës ishte shumë e rëndësishme për mua dhe pa ndihmën e së cilës ky punim do ishte tepër i vështirë për tu realizuar.

Një falenderim i veçantë për dhënien e mundësisë së përgatitjes së kësaj teze shkon për drejtuesit dhe antarët e stafit akademik të Fakultetit Juridik, pranë Universitetit të Evropës Juglindore(Tetovë).

Në fund një falenderim i veçantë shkon për familjarët e mi të cilët me mbështetjen e tyre morale, financiare dhe ajo kryesorja mbështetja njerzore kanë rrënjësuar dëshirën për të drejtën, të moralshmen dhe të ndershmen si dhe kuriozitetin për të qenë jo vetëm një kërkues shkencor por edhe një jurist i denjë.

Ju faleminderit që mëbesuat !

Përmbajtja:

KAPITULLI I

Hyrje

1.1.Lënda e hulumtimit.....	10
1.2.Qëllimet e hulumtimit.....	11
1.3.Hipotezat.....	12
1.4.Metodologjija e hulumtimit.....	13

KAPITULLI II

Aspekti juridiko-penal i dënimeve alternative në juridiksionin e brendshëm dhe atë të jashtëm

2.1. Historiku i dënimeve alternative në Republikën e Maqedonisë.....	14
2.2. Evolucionin e dënimeve alternative.....	15
2.3. Ligji për matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.....	19
2.3.1. Karakteristikat	
2.3.2. Përpersitë dhe mangësitë	
2.3.3.Matja e dënimit sipas Kodit penal aktual	
2.4. Ligji për probacion.....	34
2.4.1. Funkcioni i ligjit	
2.4.2. Zbatimi në praktikë	
2.5.Llojet e dënimeve në Republikën e Shqipërisë-dënimet alternative	40

KAPITULLI III

Dënimet alternative të RM-së në raport me dënimet alternative të Mbretërisë së Bashkuar-aspekti krahasues dhe matja e dënimit

3.1. Sanksionet penale dhe dënimet alternative në Mbretërinë e Bashkuar- karakteristikat, dallimet dhe ngjashmëritë me dënimet alternative në RM	46
3.2. Reduktimi i dënimeve alternative në RM-sukses apo dështim(duke marrë 53 parasysh se do ketë më pak dënime alternative por më shumë efektivitet)	53

KAPITULLI IV

Hulumtimi dhe rezultatet

4.1. Analiza e të dhënave statistikore.....	56
4.2. Analiza e intervistës.....	58
4.3. Analiza e pyetsorit.....	59
Përfundimi.....	63
Rekomandime.....	65
Bibliografia.....	65
Shtojcat.....	68

KAPITULLI I

Hyrje

1.Lënda e hulumtimit

Si lëndë e hulumtimit të punimit të tezës së magistraturës me temë "Matja gjyqsore e sanksioneve penale dhe zbatimi i masave alternative në Republikën e Maqedonisë" është fakti se kjo tezë paraqet një pasqyrë mbi atë se si është e rregulluar kjo sipas legjislacionit tonë dhe tregon për kushtet se si duhet shqiptuar dhe kur duhet shqiptuar që si zakonisht kemi dy lloje të matjes së dënimit edhe atë: matje ligjore dhe matja gjyqsore. Matje ligjore është ajo që është e përcaktuar në ligj kurse matja gjyqsore bazohet në matjen ligjore, dmth gjyqi e zbaton vetëm atë që është e përcaktuar në ligj. Kryesisht do bazohem dhe do bëjë analizë në lidhje me matjet e sanksioneve dhe si gjykata i shqipton ato.

Sanksionet penale janë masa shtrënguese që i shqipton gjykata në procedurë të rregullt gjyqsore ndaj kryersve të veprave penale qëllimi i së cilave është parandalimi gjeneral dhe special (frika, risocializimi, shërimi) dhe për të cilat me gjërësisht do flas gjat punimit tim. Sanksionet penale në vete përfshin tre lloje të dënimeve edhe atë: masat alternative, masat edukuese dhe masat siguruese ku theks të vecant di kenë dënimet alternative. E zgjedha pikërisht këtë temë nga shkak se në praktikë gjykata cdo ditë shqipton sanksionet penale ndaj kryersve të veprave penale ku qëllimi kryesor është jo vetëm dënimi por edhe risocializimi dmth qëllimi kryesor i shqiptimit të sanksioneve penale nuk është vec dënimi por edhe risocializimi. Gjatë punimit përvec sanksioneve penale do flas edhe për matjen gjyqsore të dënimeve të vecanta edhe atë: dënimin me burg, dënimin me gjobë, dënimet sekondare, dënimet për personat juridik, matja gjyqsore e dënimit në kornizat penale dhe jasht kornizave penale, lirimi nga dënimi, lirimi me kusht, dhe theks të vecant mbi dënimet alternative .

Për të kuptur më së miri problematikën e matjes gjyqsore dhe zbatimit të masave alternative dhe reformat që nevojiten të bëhen në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë, do shfrytzojmë legjislacionet e disa shteteve të caktuara të sistemit Kontinental dhe Anglo-Sakson kryesisht pasi që kemi edhe dy sisteme sa i përket zbatimit të masave alternative edhe atë: sistemi Kontinental dhe sistemi Anglo-Sakson dhe disa vendeve nga rajoni.

2.Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i hulumtimit është studimi dhe analiza sa i përket matjes gjyqsore të sanksioneve penale dhe zbatimi i masave alternative ku theks të vecant do ti kushtohet asaj se si gjykatat e bëjnë matjen gjyqsore të sanksioneve penale dhe dënimeve alternative si pjesë e sanksioneve penale, sa masat alternative janë të zbatueshme në praktikë, rregullat dhe rrethanat për matjen e sanksioneve dhe sa i përket masave alternative do flas për nocionin, llojet e masave alternative, cilat zbatohen më së shumti, arsyeja dhe a kanë sukses masat alternative duke marrë parasysh faktin se deri në vitin 2004 kemi pas vetëm dy lloje të masave alternative: dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqsore ndërsa pas ndryshimeve të bëra në vitin 2004 u futën edhe shumë lloje tjera të dënimeve alternative edhe atë dënimi me kusht, dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar, puna në dobi të përgjithshme, ndërprerja me kusht e procedurës penale he burgu shtëpiak duke marrë parasysh se vërejtja gjyqsore ka egzistuar edhe para ndryshimeve të bëra në vitin 2004.

Ghithashtu si qëllim pse e zgjedha këtë temë është se nuk pajtohem me faktin se në praktikë masat alternative zbatohen shumë e sidomos dënimi me kusht dhe në raste të caktuara edhe vërejtja gjyqsore por vërejtja gjyqsore më së shumti zbatohen kur kemi të bëjmë me padi private duke u bazuar në të dhëna nga praktika. Duke marrë parasysh se si kusht kryesor për shqiptimin e dënimit me kusht është që gjyqi për veprën penale të kryer të caktoj burgim deri në dy vjet ose dënim me gjobë dhe njëkohsisht e përcakton edhe kohën e kontrollit e cila nuk mund të jete më e shkurt se një vit por as edhe më e gjat se 5 vite. Nga kjo mund të kuptojmë se shanset që të ketë manipulime janë të mëdha e sidomos në një shtet si shteti ynë ku kemi sistem të rënuar të drejtisë që më së miri do mundohem ti elaboroj me shembuj gjat hulumtimit të punimit tim dhe do mundohem që me shembuj edhe nga shtete tjera kryesisht Kontinentale dhe Anglo-Saksone të tregoj zgjidhjet që do ishin më të mira për legjislacionin tonë.

Të gjitha mungesat, zbrastirat juriike dhe reformat që nevojiten në legjislacionin tonë sa i përket tematikës në fjalë do mundohemi ti plotsojmë duke marrë shembull nga vendet tjera.

3.Hipotezat

- 1.Roli i gjykatave ne zbatimin e drejtësisë, dënimin e kryersve dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarve
2. Efektiviteti i shqiptimit të dënimeve alternative nga ana e gjykatës ndaj kryersve
3. Liria e plotë e vendosjes-pavarsia dhe paanshmëria e gjykaktave, pushtet i ndarë nga pushtetet tjera
4. Besueshmëria e qytetarve ndaj pushtetit gjyqsorë
5. A kemi kushtet për shqiptimin e të gjitha dënimeve alternative?

4.Mtologjija e hulumtimit

Në përpilimin e punimit të magistraturës do të implementohen metodat dhe teknikat në bazë të hulumtimit shkencor.

Në këtë drejtim do të shfrytëzohen analiza dhe sinteza si metoda gjerësisht të shfrytëzuara për të arritur në përfundime të pranueshme dhe logjike të arsyeshme.

Në vijim do përdor këta metoda:

Metoda historike- analiza e çështjes për zhvillimin e saj për një periudhë në RM dhe sa i përket zbatimit të saj. Këtë metodë do ta përdorim kur do të paraqesim studime tjera të bëra për të njëjtën çështje në vendin tonë nga autorë tjerë.

Metoda statistikore- do përdoren për përpunimin e të dhënave që do meren nga Gjykatat e vendit dhe nga Enti për Statistika.

Metoda krahasuese- do të përdoret për të përcaktuar ngjajshmëritë dhe dallimet ndërmjet studimeve tjera të bëra në të njëjtën fushë, por në vende të ndryshme.

Analiza dhe sinteza metodologjike- kjo metodë do të përdoret për paraqitjen logjike të lëndës së hulumtimit në nxjerrjen e konkluzioneve të përgjithshme dhe prandaj është shumë më rëndësi për të ofruar rekomandimet e duhura.

Metoda kualitative dhe kuantitative- duke përfshirë intervista dhe pyetsorë.

KAPITULI II

Aspekti juridiko-penal i dënimeve alternative në juridiksionin e brendshëm dhe atë të jashtëm

2.1. Historiku i dënimeve alternative në Republikën e Maqedonisë

Seanca e parë e ASNOM-it paraqet kurorën e luftës antifashiste dhe nacionaliste e popullit maqedonas për formimin e shtetit maqedon e mbajtur më 2 gusht 1944 nga ku RM e sotme bëhet shtet, kurse ASNOMI orgni më i lartë në shtet dhe i vetmi trup ligjvënës¹. Dënimet alternative për herë të parë janë përmendur në dënimin me kusht si pjesë përbërse e Kodit Penal të ish RSFJ-së më 1951 dhe novelave të vonuara². KP i vitit 1951 është ndryshuar disa herë. Në vitin 1959 është reformuar sistemi i sanksioneve në KP. Dënimet sa i përket braktisjes së dënimit me kufizim janë ngushtuar kurse është bërë zgjerimi i masave siguruese si: mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve. Në vitin 1962 kemi përsëri zgjerim të masave siguruese. Në 1971 kemi ndarje të kompetencave midis federatës dhe republikave (disa prej tyre ishin krahina si psh krahina e Kosovës dhe Vojvodinës). Më 1976 janë bërë përsëri ndryshime në Kodin Penal të cilat ndryshime kanë hyrë në fuqi në vitin 1977. Pasi në 1991 bëhet panvarsimi i Republikës së Maqedonisë nga RSFJ-ja, Kodi Penal që ishte në fuqi në kohën e Jugosllavisë ishte ai që shërbente si burim i vetëm penal në RM e pavarur. Kodi i parë Penal i Republikës së Maqedonisë ka qenë Kodi i cili u miratua më 23 korrik 1996 nga parlamenti i Republikës së Maqedonisë dhe i cili hyr në fuqi më 1 nëntor 1996.³ Kishte dy faza reformatore dhe dy novela ndryshuese. Gjat kësaj periudhe, qëllimi kryesor i Kodit Penal ishte pastrimi nga mbetjet dhe mbeturnat e sistemit socialist duke i kushuar rëndësi të madhe lirive dhe të drejtave të njeriut si premisë kryesore e Kushtetutës së re të Republikës së Maqedonisë. Në vitin 1977 Kuvendi i RM-së miratoi Ligjin për procedurën penale. Faza e parë është ajo e vitit 1996 kur për herë të parë u formua Kodi Penal. E drejta penale është një instrument ku vin në shprehje raporti mes qytetarit përmes lirive dhe të drejtave të veta dhe shtetit si mbrojtës i këtyre të drejtave përmes pushtetit gjyqsor, nga ku nënkuptojmë se e drejta penale apo ligji penal është i vetmi mjet ku janë të paraparadënimet për personat të cilët i cënojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Në këtë fazë poashtu rëndësi

¹ Vllado K., E drejta penale 2010, f.45

² Види, Бачиќ 1972, f.673

³ Vllado K., E drejta penale 2010, f.47-48

tëposaçme i është kushtuar edhe reformave në sistemin e sanksioneve penalo-juridike⁴. Kemi dy novela të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë edhe atë ajo e vitit 1999 dhe ajo e vitit 2002. Faza e dytë është ajo e vitit 2004 ku Maqedonia në po at vit lidhi marrëveshjen për stabilizim dhe asocim me Unionin Evropian ndërsa dënimet alternative morën një qasje të veçantë sepse shqiptoheshin për të gjitha veprat e lehta për të cilat ishte parapa dënim deri në dy vjet⁵. Duke filluar nga Kodi Penal vitit 1951 janë paraparë dënimet alternative si dënime për veprat më të lehta që dënohen deri në dy vjet ku në fillim kemi pasur vetëm disa lloje të dënimeve alternative kurse në Kodin e 1966 kemi vet tre lloje të dënimeve alternative edhe atë: dënimi me kusht, vërejtja gjyqsore dhe dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar dhe që këta dënime kanë qenë të tilla deri në vitin 2004 ku më pas pësuan ndryshimet⁶.

2.2. Evolucion i dënimeve alternative

Me termin dënime alternative si pjesë e sanksioneve penale nënkuptojmë dënimet qëllimi i të cilave është që ndaj kryesve të veprave penale për të cilat është paraparë dënim më i lehtë deri në dy vite dhe sipas të cilave mendohet se me shqiptimin e po këtyre dënimeve dënimve alternative do arrihet qëllimi i dënimit.⁷ Siç e cekta edhe në fillim të punimit tim se dënimet për hrë të parë janë zbatuar në Kodin Penal të vitit 1951 të ish RSFJ-së. Për dallim nga Kodi Penal i vitit 1996 ku ka pasur tre lloje të dënimeve alternative edhe atë: dënimi me kusht, vërejtja gjyqsore dhe dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar dënime të cilat kanë qenë deri në vitin 2004 ku më pas janë shtuar edhe këta llojet e tjera të dënimeve alternative që i kemi sot. Në vitin 2004 me ndryshimet e bëra kemi ndryshim në nenin 48 të Kodit Penal i cili nën kishte të bëjë me "qëllimin e dënimit me kusht dhe vërejtjes gjyqsore", me ndryshimet e bëra në Kodin Penal të vitit 2004 neni 48 u ëvendësua me shkrimin me "qëllimin e dënimeve alternative" dhe gjithashtu u shtua edhe neni 45-a sa i përket llojeve të dënimeve alternative.⁸ Nga kjo rezulton se dënimet alternative me ndryshimet e bëra në vitin 2004 u shtuan ku nga tre u bënë gjashtë dënime alternative. Nëse bëjmë një krahasim me dënimet alternative kur ishin vetëm tre dhe tani që janë gjashtë do vhet re një dallim i madh pasi që dënimt alternative shqiptoheshin fiks vetëm për

⁴Vllado K., E drejta penale 2010, f.49-50

⁵ Vllado k., E drejta penale 2010, f.54-56

⁶ Kodi Penal i Maqedonisë, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.37/96

⁷ Neni 48 i Kodit Penal të Maqedonisë,

⁸ Kodi Penal i Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.37/96, Ligji për emërim dhe ndryshim në Kodin Penal, Gazeta Zyrtare, nr.19/04

dënimet e lehta kurse tash që ka më shumë dënime alternative mirëpo shqiptohet vec një dënim alternativ-dënim me kusht. Duke u bazuar nga rezultatet e praktikës personale mund të them se shumica e dënimeve që i shqipton gjykata janë dënime alternative edhe atë kemi vetëm një lloj të dënimeve alternative më të theksuar edhe atë dënim me kusht. Si rezultat i kësaj, lind pyetja, a është Maqedonia e gatshme për zbatimin e plotë të dënimeve alternative?

Nëse flasim për masat alternative si dënime duke marrë parasysh edhe aspektin normativ, duhet marrur parasysh edhe hulumtimet dhe analizat e e deri tanishme duke pasur parasysh edhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve mirëpo nuk mund të thuhet asgjë fikse dhe konkret sa u përket masave alternative dhe zbatimit të tyre në praktikë. Në vitin 2008 janë ndërmarrë disa masa për zbatimin e tyre në praktikë nga ku mund të përmendim aktet nenligjore-rregulloren sa i përket kushteve dhe mënyrës së zbatimit të punës në dobi të përgjithshme nga ku mund të përmendim Rregulloren për kryerjen e punëve profesionale gjatë zbatimit të masave alternative dhe marrëveshjen për punën në dobi të përgjithshme. Sipas analizave dhe statistikave duke e ditur se nga të gjitha dënimet alternative zbatohen dënim me kusht dhe vërejtja gjyqsore më së shumti, kjo është si rezultat i mos ekzistimit të kapacitetit nga institucionet, jo gatishmëria e gjyqtarve për shqiptimin e sanksioneve tjera dhe mos egzistimi i rregullativave ligjore dhe nenligjore.⁹ Me evoluimin e së drejtës sonë penale jo vetëm se u bë zbutja e sistemit të drejtësisë dhe reagimi ndaj kryerësve të veprave penale nga ana e shtetit por edhe sa i përket sanksioneve penale të cilat nuk e bëjnë kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, por është vetëm një kërcënim kinse u meren të drejtat me qëllim që edhe të ai por edhe të tjerët të ndikojë që të mos kryejnë vepra penale duke morë haruar edhe qëllimin e së drejtës penale dhe e cila vepron **post festum**.

Dënimet alternative janë dënime që shqiptohen si zëvendësim i burgut sipas të cilave burgu duhet të jetë alternativa e fundit që duhet menduar. Si në aspekt praktik poashtu edhe në atë teorik kjo tendencë ka cuar shumë vende dhe legjislacione të Evropës të mendojnë për sjelljen e dënimeve tjera alternative dhe zbatimin e teknikave dhe metodave të tjera.¹⁰ Dënim me burgim ka qenë një nga dënimet kryesore që e ka njohur pothuaj çdo legjislacion dhe ka qenë një ndër dënimet më efektive. Por me kalimin e kohës u vërejt se ky lloj dënim i ishte vetëm qëllim ndëshkues e nuk kishte ndonjë qëllim tjetër sa i përket resocializimit.¹¹ Gjithashtu vlen të përmendet se në

⁹<http://journal.makc.mk/wp-content/uploads/2017/05/Dzemali-Saiti.pdf>

¹⁰<http://journal.makc.mk/wp-content/uploads/2017/05/Vitlarova-Tamara.pdf>

¹¹Гордана Лаѓжетиќ-Бужаровска."Алтернативи на затворот", Shku, 2003, f.29-30

bazetëanalizave të bëra është konstatuar se dënimi me burg ndikon negativisht te kryersi sidomos rrethanat kur rin në burg e bëjnë edhe më agresive atë ku ai largohet nga familja nga miëqt nga rrethi dhe nga cdokush duke marrë parasysh si lumturinë si integritetin personal tq gjitha i shkatrohen dhe në fund të fundit mund vetëm të themi se nuk ka asnjë rezultat dhe për këtë shkak kohës fundit shkohet më së shumti në zbatimin e dënimeve alternative pa mos haruar ehe ndëshkimet që një i burgosur i përjeton brendaa në burg.Dmth dënimi me burg mendodhet sipas mendimeve në aspekt ndërkombëtar preferohet si mundësia e fundit e dënimit të personave kryesisht për vepra të rënda vepra për të cilat nuk mund të jepetn dënime alternative, gjithashtu kur bëhet fjalë për persona me dosje kriminale, për recidivist, njerëz që janë të rrezikshëm për rrethin dhe familjen pa dyshim që ndaj këtyre personave do shqiptohet dënim me burgim ose edhe dënimin me vdekje edhe pse vendi jonë nuk e parasheh këtë lloj dënimi pasi që u hoq në vitin 1991.¹² Padyshim duhet kuptuar se masat alternative janë pjesë e sistemit penal dhe duhet pranuar si të tilla. Gjykata para se ti shqiptojë i mer parasysh të gjitha rrethanat dhe parakushtet për shqiptimin e këtyre dënimeve.Janë dënime të cilat parashohin kushte për kryersit por njëkohsisht ofrojnë edhe ndihmë për personat e dënuar. Duhet të egzistojnë shërbime speciale sa i përket implementimit. Në disa vende të botës dënimet alternative mbikëqyren nga shërbimi i probacionit, në disa vende tjera nga policia të cilët thuaj se aspaknuk mund të ju ndihmojnë për shkak se aktivitetet e tyre janë në kundërshtim me rregullat e policisë¹³. Në disa vende ka shërbyes të burgut dhe drejtori të probacionit. Sa i përket aspektit ekonomik janë më të lira në krahasim me burgun por kjo vlen më shumë për dënimin me kusht qëështë më i liiri kurse burgu shtëpiak është një ndër më të shtrejtntit dhe gjithashtu edhe mbi populimi i burgjeve dmth se kta masa janë të nevojshme.¹⁴Dënimet alternative e personifikojnë idejën kryesore të sistemitaktual penal dhe reformave të atij sistemi duke e kufizuar zbatimin e dënimit me burg dhe duke shkuar në trajtimin e kryerësve jasht burgut. Kjo ide apo kjo tendencë kamar edhe përkrahje ndërkombëtare dhe si rezultat i përkrahjes së kësaj tendence sa i përket dënimeve alternative në vitin 1992 Komiteti i ministrave për miratimin e rregullave sa i përket dënimeve alternative të zbatueshme në bashkësi(comunity sanctions and measures) miratoj Rekomandimin nr.P 92/16 . Me sanksione të bashkësisë nënkuptojmë sanksione ku personat nuk dërgohen në burg por bëhet

¹²Гордана Лаѓжетиќ-Бужаровска."Алтернативи на затворот", Shku, 2003,f.31

¹³Гордана Лаѓжетиќ-Бужаровска."Алтернативи на затворот", Shkup, 2003,53-58

¹⁴Dr.Zvonimir Separovic, "Alternative kazni zatvora",Sarajevë,1988(punim i prezantuar nw mledhjen e katedrave penale tw mbajtura nw Sarajevw)

vetëm kufizimi i disa të drejtave por duke mar parasysh faktin se këta persona ngelin në bashkësi dmth u japin detyrime të caktuara apo kushte dmth psh dënimi me kusht.¹⁵ Dënimet alternative tregojnë se tendencën sa i përket sistemt të sanksioneve dhe reformave bashkëkohore. Qëllimi këtu është ikja në max e dënimit me burg dhe batimi i dënimeve alternative si dënime të komunitetit. Kjo shihet edhe nga aspekti teorik por edhe nga aspekti praktik nga shkaku se zbatimi i dënimit me burg dekadat e fundit nuk ka sukses pasi shkohet në gjetjen e masave alternative apo alternativa të burgut që e shohin si zgjedhje më të përsatshme për kryesit që kryesisht bëjnë krime për të cilat është i paraparë dënimin i ulët deri në dy vite.¹⁶ Ky proces përkrahje ka pas edhe nga OKB-ja e cila i ka pranuar si dënime të përshtatshme për zëvendësimin e dënimit me burg dhe në mledhjet që janë mbajtur në Karkakas-1980, Milano-1985 dhe Havana në vitin 1990 ku janë miratuar rregullat minimale dhe standardet jo burgosëse të njohura si rregullat e Tokios.¹⁷ Rregullat e Tokios paraqesin një sistem të formuar nga ideja se dënimi me burg është dënimi i fundit që duhet të vij në shprehje dhe parashohim gjithashtu ekuilibër sa i përket të drejtave mes kryesit viktimës dhe shoqërisë. Mund të përmendim disa lloje aktivitetesh edhe atë: dënimi me kusht, puna në dobi të përgjithshme lirmi me kusht, dënie gjysme ditore, masa të policisë dhe prokurorisë.¹⁸ Egziston dyshim sa i përkt nocionit të dënimeve alternative si psh masa preventive apo kontroll apo dënimin jashta objekteve të burgjeve. Sipas mendimeve të disa autorëve kjo është një vepër që autori i veprës e mban në bashkësi e jo në institucione. Nëse flasim për dënimet alternative që janë reduktim apo apo heqje dorë nga zbatimi i dënimeve me burgim, nuk duhet haruar se edhe mes dënimeve alternative kemi dënime që nuk nuk janë alternativë e burgut dmth që ti iket burgut por e kanë rolin e atillënga shkaku se shqiptohen për dënime kryesisht më të lehta¹⁹. Duke mar parasyh se në sistemin tonë kemi gjasht lloje të dënimeve alternative edhe atë: dënimi me kusht, dënimi me kusht membikqyrje të shtuar, ndërprerja me kusht e procedurës penale, puna në dobi të përgjithshme, vërejtje gjyqsore dhe dhe burgu shtëpiak. Sa i përket dënimit me kusht shqiptohet për për vepra deri në dy vite apo dënim me gjobë dhe e cila mund të zgjas prej 1 vit deri në 5 vite. Kemi dy sisteme: anglo-sakson dhe eurokontinental. Sipas të parit nënkupton suspendim të dënimit dhe mbikqyrje kurs e dyta

¹⁵ Vllado Kambovski, "Komentar na Krivicniot Zakonik", 2016, Поим на алтернативни мерки, f.518

¹⁶ Afrim Osmani, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup, 2013, f.258

¹⁷ Të miratuara me rezolutën e Asamblesë së përgjithshme të OKB-së në vitin 1990

¹⁸ Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mosarrestimit (Rregullat e Tokios) 1990

¹⁹ Vllado Kambovski, "Komentar na Krivicniot Zakonik", 2016, f.519

nënkupton shtyerje e ekzekutimit të dënimit pa mbikqyrje.²⁰Kemi edhe revokimin e dënimit me kusht në rast të kryerjes së veprës penale apo për vepër të mëparshme që i ka kryer personi.Ndërprerja me kusht e procedurës penale shqiptohet për vepra penale deri ne një vit apo për dënime me gjobë. Ky dënim u fut në sistemin tonë me ndryshimet e bëra në vitin 2004 Është lloj i dënimit alternativ që për dallim nga dënimi me kusht dhe dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar dallon në atë se dënimi me kusht dhe dënimi me kusht me mbikqyrje e suspendon dënimin dmth procedura nuk zhvillohet aspak kurse te ky lloj dënimi procedura zhvillohet. Mund të thuhet se është një dënimin i bazuar në mediacion dmth drejtësi restorative.²¹Vërejtja gjyqsore shqiptohet për vepra deri në një vit apo për dënime me gjobë.Mund të shqiptohet edhe për vepra deri në tre vite. Fillimet e vërejtjes gjyqsore janë në shekullin XIX. ku sa i përket këtyre dënimeve kemi dy qëndrime:atë të shumicës dhe atë të pakicës. Shumica mendonte se ishte dënimin efikas sepse shërbente vetëm për veprat e lehta kurse pakica mendonte se sistemi i sanksioneve nuk ka nevojë për një dënim të tillë. Thash se zbatohet edhe për veprat që dënohen deri në tre vjet si psh neni.130 paragrafi 2 qëështë për lëndim të lehtë trupor i bërë gjat dhunës familjare.²²Një shembull sa i përketdënimeve alternative është edhe dënimi me kusht është që i shqiptohet futbollistit Cristiano Ronaldo i cili akuzohet se nuk ka paguar 14.7 milion euro dënime për të drejtat e tij të imazhit dhe për të cilën në Janar të viti 2019 është dënuar me 18.8 milion euro dënim pasi është dashur që të shkojë në burg mirëpo sipas ligjit spanjoll kryersi primaar mund të bëjë deri 2 vite burg kështu që mundet ti shqiptohet edhe dënim alternativ në këtë rast dënim me burg eri në 23 muaj dhe dënim me gjobë.²³

2.3. Ligji për matjen e dënimit

2.3.1. Karakteristikat

Ligji për matjen e dënimit është ligj i cili u soll më 30.12.2014 dhe shërbente për matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, për krijimin propozim marveshjes për llojin dhe lartësinë e dënimit mes prokurorit dhe të dënuarit sipas marveshjes dhe formimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit për barazim të politikës ndëshkuese sipas së cilit gjyq mund tja bëj zbutjen e dëniit

²⁰ Vllado Kambovski, "Komentar na Krivicniot Zakonik", 2016, neni.49, neni.50, f.521, f.522-523

²¹ Vllado Kambovski, "Komentar na Krivicniot Zakonik", 2016, neni.58-a, f.536-537

²² Vllado Kambovski, "Komentar na Krivicniot Zakonik", 2016, neni.59, f.541-542

²³[http:// www.telegraph.co.uk/news/2019/01/22/cristiano-ronaldo-avoids-prison-accepts-19-million-fine-spain/](http://www.telegraph.co.uk/news/2019/01/22/cristiano-ronaldo-avoids-prison-accepts-19-million-fine-spain/)

*kryerësit të veprës penale nëse ka marveshje me prokurorin. Qëllimi i ligjit është barazimi i politikës ndëshkuese gjatë shqiptimit të dënimeve nga ana e gjykatave në RM bazuar në kritere të caktuara objektive për matjen e lartësisë së dënimit²⁴. Ky ligj bazohet në 6 parime kryesore: ligjshmëri, individualizim i dënimit, proporcionlitet të dënimit, efikasitet, barazim i politikës ndëshkuese dhe transparencë. Komisioni është trup i pavarur që kujdeset për barazimin e politikës ndëshkuese gjatë shqiptimit të dënimit duke ofruar modele të reja sa i përket matjes së dënimit. Përbëhet nga 7 antarë dhe ka të rejt që të kujdeset për politikën ndëshkuesetë gjyqeve në RM, çon propozime te Ministria e Drejtësisë, i jep raport Parlamentit.*²⁵Përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit gjyqtari e përcakton duke u bazuar në dy kritere: kategorizimi objektiv i veprës penale dhe jeta e mëparshme e kryerësit. Veprat penale të përfshira në Kodin Penal janë të klasifikuara në dy kategori: në atë horizontale dhe atë vertikale.²⁶Në çdo klasifikim horizontal panvarisht se çfarë lloji dënimi është paraparë për një vepër të caktuar domethënë parasysh minimumi dhe maximumi i dënimit që do të shqiptohet personit duke u mvarur nga ajo se në cilën kategori vertikale do të klasifikohet i dënuari. Sa i përket klasifikimit vertikali si kriter për jetën e mëparshme të kryerësit duke u bazuar në lartësinë e dënimit gjyqi do të vendosë duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe me anë të kësaj do të bëjë individualizimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prandaj fjalë për kategorizim objektiv të veprës penale (**klasifikim horizontal**) dhe jetën e mëparshme të kryerësit (**klasifikim vertikal**).²⁷Rrethanat lehtësuese dhe rënduese llogariten duke shtuar apo duke hequr poenë ku si baza meren vlerat e llojit të dënimit të shqiptuar në çdo kategori vertikale. Shembull është nëse gjykata një personi të caktuar i shqipton dënim me burg deri në 24 muaj dhe gjatë shqiptimit egziston ndonjë rrethanë lehtësuese dhe dallimi mes rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese është 5 në favor të atyre lehtësuese gjykata vendimin me burg mund të ja kushtëzojë apo të japë vendim me kusht nëse mendon se me këtë do të arrihen qëllimet e dënimit në kuptimin e preventivës speciale dhe gjenerale.²⁸ Shembull sa i përket klasifikimeve horizontale dhe vertikale: nëse për një vepër të cilën është paraparë dënim nga 3 muaj deri në 5

²⁴ **cit**at-neni.1, **cit**at-neni.2, Ligj për përcaktimin e llojit dhe matjen lartësisë së dënimit, Gaz. Zyrtare e RM-së, nr. 199/14

²⁵ **cit**at-neni.3, **cit**at-neni.4, **cit**at-neni.5-6, Ligj për përcaktimin e llojit dhe matjen lartësisë së dënimit, Gaz. Zyrtare e RM-së, nr. 199/14

²⁶ Ligj për përcaktimin e llojit dhe matjen lartësisë së dënimit, f.3-5, Gaz. Zyrtare e RM-së, nr. 199/14

²⁷ www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2014/02/Upatstva-za-odreduvane-na-vidot-i-odmeruvane-na-visinata-na-kaznata.pdf

²⁸ Ligj për përcaktimin e llojit dhe matjen lartësisë së dënimit, f.5-6, Gaz. Zyrtare e RM-së, nr. 199/14

vjet(klasifikim horizonta XXII). Në muaj i bjen nga 3-60 muaj. Nëse personi që e ka bërë veprën është i (pa dënuar) sipas kategorisë vertikale I i bie që ti shqiptohet dënim nga 3-24 muaj.²⁹

Jeta e mëparshme e kryer si klasifikim vertikal

I. i padënuar

II. deri në dy aktgjyime të plotfuqishme për vprat për të cilat është paraparë dënim me gjobë apo apo dënim me burgim deri në 5 vite

III. deri në dy aktgjykime të plotfuqishme ku të paktën për një veprë penale është paraparë dënim mbi 5 vite

IV. tre apo dy aktgjykime të plotfuqishme për të cilën është paraparë dënim efektiv der 6 muaj apo një aktgjykim me dënim efektiv më së paku deri 3 vite

V. katër apo dy aktgjykime të plotfuqishme për të cilat është paraparë dënim më së paku dy vite ose një aktgjykim ku është paraparë dënim më së paku deri në 5 vite

VI. pesë ose më shumë aktgjykime të plotfuqishme ose dy me dënim prej së paku 5 vite ose një aktgjykim me dënim më së paku prej 8 vite³⁰

Kategorizimi objektiv i veprës penale si klasifikim horizontal

I. dënimi me gjobë-30-60 gjoba ditore, 40-80 gj.d, 80-100 gj.d, 100-130 gj.d, 130-160 gj.d, 160-180 gj.d

II. dënim me gjobë apo burgim deri 3 muaj-dënim me gjobë-30-60 gjoba ditore, dënim me gjobë-40-80 gj.d,0-3 muaj burgim- 80-100 gj.d,0-3 muaj burgim- 100-130 gj.d,0-3 muaj burgim- 130-160 gj.d,0-3 muaj burgim- 160-180 gj.d

III. dënim me gjobë apo burgim deri 6 muaj-dënim me gjobë-30-80 gj.d, 0-6 muaj burg-50-100 gj.d, 3-6 muaj burg-90-130 gj.d, 3-6 muaj burg-120-200 gj.d, 3-6 muaj burg-180-220 gj.d, 3-6 muaj burg-jo

IV. burgim deri 6 muaj-0-3, 0-6 muaj, 3-6 muaj, 3-6 muaj, 3-6 muaj, 3-6 muaj

²⁹www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2014/02/Upatstva-za-odreduvane-na-vidot-i-odmeruvane-na-visinata-na-kaznata.pdf

³⁰ Ligj për përcaktimin e llojit dhe matjen lartësisë së dënimit,f.5,Gaz.Zyrtare e RM-së,nr.199/14

V. dënim me gjobë ose burg deri 1 vit-gjobë/2 muaj burg-40-100 gj.d, 3-5 muaj burg-70-150 gj.d, 4-6 muaj burg-120-200 gj.d, 5-7 muaj burg-150-250 gj.d, 7-9-jo, 9-12-jo

VI. burg deri 1 vit ose dënim me gjobë-2 muaj burg dhe d.me gjobë, 3-5 muaj burg dhe d.me gjobë, 4-6 muaj burg dhe d.me gjobë, 5-7 muaj burg dhe d.me gjobë, 7-9 muaj burg dhe dënim me gjobë, 9-12 muaj burg dhe dënim me gjobë³¹

2.3.2. Përparsitë dhe mangësitë e Ligjit për matjen e dënimit

Duke pasur parasysh ndryshimet e bëra në vitin 2014 në sistemin tonë penal u fut edhe i njeiti ligj ku në përputhje me nenin 39 paragrafi 3 të Kodit Penal kryetari i Gjykatës Supreme solli rregullore mirëpo për shkak se ajo ishte në kundërshtim me maksimën juridike "Nullum cime nullum poena sine lege"që është parimi themelor i sistemit penal modern e njeiti u shfuqizua. Por prap më vonë Parlamenti i Maqedonisë e solli si ligj me ndryshime të vogla. Mangësitë e këtij ligji janë të shumta sa që nuk din nga tja fillosh. Si fillim emërtimi nuk është si duhet kurse në brendi flet për të gjitha sanksionet. Kjo është njëjtë sikur të krijosh një ligj për mardhënet detyrimore dhe në tëta fusish të drejtën civile, familare, trashëgimore. Mangësia tjetër ka të bëjë me barazimin e politikës ndëshkuese e paraparë në nenin 3 paragrafi 5 i këtij ligji, por ne të gjithë e dimë se politika dhe principi janë dy terme të kundërta. Shembull konkret: "Jo e drejta asnjëherë nuk mund të bëhet e drejtë". Mund ta përmendim edhe faktin se në ligj përmenden kategorizime objektive sa i përket veprës penale-kategori horizontale dhe jeta e mëparshme e kryerit-kategori vertikale, kjo dmth gjykatësi të filloj të bëjë llogari matematikore për ta dënuar kryerit duke u bazuar në rrethana lehtësuese dhe rënduese ku e njeita vlen edhe për kryerit i cili mund ta llogaris dënimin e vet dhe të vendos se a i konvennon të bëjë vepër kriminale(penale) gjë e cila është e pa tolerueshme. Arsimi është gjithashtu një mangësi sepse arsimi merit si rrethanë lehtësuese dmth nëse një profesor apo një ekonomist kryen vepër penale do dënohet më lehtë a në fakt duhet dënuar rëndë nëse ka bërë vepër, njëjtë si cdokush tjetër. ³²Kjo na kthen në shekullin XIX ku gjyqtari nuk ka bërë asgjë po veç e ka thënë atë që ka qenë në ligj as më pak as më shumë. E rëndësishme këtu të përendet është edhe marveshja e prokurorit dhe të pandehurit që nënkupton se gjyqtari mund ta bëjë zbutjen e dënimit vetëm nëse egziston një marveshje e tillë por në fakt në Kodin nuk ka një institut të këtillë por ka institut të prurjes së akt gjykimit në

³¹www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2014/02/Upatstva-za-odreduvane-na-vidot-i-odmeruvane-na-visinata-na-kaznata.pdf

³²www.akademik.mk/wp-content/uploads/2016/09/Zlatko-Predavane-za-Akademik.pdf

bazëtë propozim marveshjes për pranim të fajit pasi kjo është luks i tepërt për të pandehurindhe si fakt tjetër mund të përmendim se i pandehuri fajin mund ta pranoj vetëm në shqyrtim kryesor e cila paraqet një kërcënim legal qësështë e thënë i pandehuri fajin ta pranojvetëm në shqyrtim kryesor nga ku krijohen edhe më shumë dyshime se të gjithë mund të lirohen nëse egziston një marveshje e tillë, nga ku mund të themi se i njejt fajin mund tapranoj edhe nëprocedurënprovuese³³, nga kjo del se ky ligj paraqiste një hendek të madh në sistemin tonë të mjerueshëm të drejtësisë dhe e njejta ishte një loj bixhoz që luante me fatin e njerëzve dhe mos egzistimin e mundësisë për ndarje të drejtë të drejtësisë pasi sipas meje ligji bënte ndarje mes kryerësve të veprave penale duke u bazuar në përkatsinë arsimoredhe i njejt paraqiste sulm direkt i individualizimit të dënimeve penale dhe kësso ligje nuk ka as në Evrop po as edhe në Amerik gjë që nënkupton se jemi specifik sa i përket fushës së ligjeve që mund të themi se ky ligj paraqiste cënim edhe të të drejtave të njeriut, nga ky shkak dhe pas debatit të shumë profesorve në vend duke thënë se i njejt ligj nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e RM-së dhe një sërë dobësi tjera që i kishte gjyqtarët e gjykatës kushtetuese të njejtin në nëntor të vitit 2017 e shfuqizuan.Por mund të themi se si mangësi më e madhe këtu është se tash që ligji u shfuqizua egziston rrezik edhe më i madh sa i përket matjes së dënimit gjatë zbatimit të dënimeve për politikanët aktual duke e ditur sistemin gjyqsor te ne, do mundohen që ti dënojnë me dënimet minimale pasi që tashme dihet se matja e dënimit bëhet në kuadër të Kodit Penal por duke u bazuar edhe në sistemin akuzator që e ka RM aktualisht ku gjykatësi vendos në bazë të bindjes së vet panvarsisht se në Kod është e përcaktuar dhe e definuar, lind pyetja se a do arrihen që të gjithë këta politikan kriminel dhe ish politikan të dënohen për të gjitha veprimet e tyre kriminale?

Sanksionet penale janë masa shtrënguese që i shqipton gjykata në procedurë të rregullt gjyqsore ndaj kryerësve të veprave penale qëllimi i së cilave është parandalimi special dhe gjeneral. Sanksionet penale në vete përfshin tre lloje të dënimeve: masat alternative, masat edukuese dhe massat siguruese me theks të veçantë për masat alternative duke marrë parrasysh dhe temën që e kam pikërisht për këtë temë. Shkaku pse unë e zgjodha pikërisht këtë temëështë se në praktikë në gjykatë gjykatësit çdo ditë shqiptojnë sanksione penale ndaj kryerësve qëllimi i së cilës është jo vetëm dënimi por njëkohsisht edhe risocializimi i kryerësve, Mirëpo gjykatësi bën matjen e dënimit gjatë shqiptimit tëkëtyre sanksioneve penale me theks të veçantë për matjen e dënimit

³³www.akademik.mk/wp-content/uploads/2016/09/Zlatko-Predavane-za-Akademik.pdf

gjatë shqiptimit të masave alternative. Siç e dimë nga E drejta Penale e RM-së, kemi dy lloje të matjes së dënimit: matja ligjore e dënimit dhe matja gjyqsore e dënimit.³⁴

2.3.3. Matja gjyqsore e dënimit sipas Kodit Penal aktual

Me matje ligjore të dënimit nënkuptojmë përcaktimin apo defimin me ligj të dënimit nga ana ligjvënësit. Këtu ligjvënësi e ka parasysh se kemi vepra të ndryshme dhe kryerës të ndryshëm. Kemi dy sisteme sa i përket matjes ligjore të dënimit: sistemi absolut i dënimeve dhe sistemi relativ i dënimeve. Sa i përket sistemit absolut kjo nënkupton drejtësis arbitrare apo vet drejtësi, e cila për here të parështë paraqitur në shekullin e XIX në Kodin Penal Francez dhe kjo nënkuptone gjat kohës së sistemit absolut egzistonte dënimi me vdekje për vepra të rënda, mirëpo ky sistem më vonë u zëvendësua nga sistemi relativ dhe dënimi me vdekje pothuaj se nuk egziston në asnjë vend dhe i njëjti është zëvendësuar me dënimin me burg të përjetshëm. Siç thash se nuk egziston më sistemi absolut i dënimeve të përcaktuara por kemi sistem relativ që nënkupton se matja e dënimit dhe vlersimi për çdo vepër penale bëhet nga ana e ligjvënësit nga ku edhe janë përcaktuar në mënyrë të precizuar të gjitha dënimet që mund të shqiptohen në raste konkrete mvarsisht se për çfar veprë bëhte fjalë.

Duke u bazuar në matjen ligjore të përcaktuar nga ligjvënësi, me matje gjyqsore nënkuptojmë kur gjyqtari bën precizimin apo konkretizimin e dënimit për veprën e caktuar penale e cila është paraparë nga ana e ligjvënësit. Karakteristik tjetër e matjes gjyqsore të dënimit është edhe ajo se gjykatësi në rastin konkret vendim mund të sjell duke u bazuar vetëm në fakte dhe prova e jo duke marrë parasysh personalitetin e kryerësit dhe vlen të përmendet edhe fakti se gjykatësi nuk mund të vendos vet në një çështje konkrete por duhet të kontrollohet edhe nga gjykatësi i instancës më të lartë.³⁵ Kemi dënime kryesore dhe dënime sekondare ku si dënime kryesore janë burgu dhe gjoba kurse si dënime sekondare janë: ndalimi i ushtrimit të profesionit, ndalimi i drejtimit të automjetit dhe dënimi i të huajit nga vendi. Sa i përket matjes së dënimit për veprat të dënimit me burg duhet cekur fakti se min i burgut është 30 ditë kurse max është 20 vjet. Për veprat për të cilat është paraparë dënim deri në 20 vite, nëse vepra është kryer në rrethana tepër rrënduese mund të shqiptohet edhe dënimi me burgim të përjetshëm. Në rast se për vepra të caktuara është i

³⁴duke iu referuar të gjitha shënimeve të mara gjatë ligjeratave në të drejtën penale sa i përket matjes së dënimit dhe dënimeve alternative

³⁵Villado K., E drejta Penale, 2010, f.529-532

paraparëdënim me burgim nga ku nuk është paraparë masa më e vogël kurse masa më e madhe është deri në tre vite, në këto rastë mund të shqiptohet edhe dënim me gjobë.³⁶

Burgu kryesisht u paraqit nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX pasi u larguan dënimet me vdekje dhe dënime trupore. RM-ja është një ndër vendet abolicioniste të dënimit me vdekje. Viti 1987 është hera e fundit që gjykatat e RM-së kan shqiptuar dëmin me vdekje ndaj një pedofilit nga Zajazi i cili e kishte prdhunuar, mbytur dhe djegur vajzën e vet i cili pas disa ditëve ishte pushkatuar. Ishte koha e ndryshmeve të mëdha industriale që u bënë në këtë kohë. Undërtuan shumë nstitucione, spitale, shkolla dhe kryesisht burgje. Roli i burgut ishte dytsor pasi në burg shkoheshte vetëm kur përcaktoheshte paraburgim, dënim me vdekje dhe dënime tjera të cilat shqiptoheshin mirëpo këta mbaheshin në burg. Për të njëjtën mendim ka dhënë edhe Ulpiani që ka thënë se burgu duhet sfrytzuar vetëm për dënime të përkohshme.³⁷ Me kalimin e kohës dënimi me burg u përmirsua ku si qëlim kryesor i burgut ishte resocializmi i kryerësit, prsonaliteti i kryerësit dmth gjatë matjes së dënimit me burg gjykatsi patjetër duhet ta personalizoj dënimin dmth ktu vjen në shprehje individualizimi(parimi i individualizimit) i dënimit që nënkupton se kryerësi nuk mund të dënohet për ndonjë vepër tjetër penale por as nuk guxon që të dënohet më pak për veprën që e ka bërë, thënë shkurt as më lart e as më posht por duhet marrë dënimin e merituar dhe në fund, ku mund ti përmendin edhe fazat kur personi në fillim lihet në vetmi dmth paraburgimi, më pas dënohet ku dënimin e vuan bashk me tjerët dhe në fund kemi edhe lirimin me kusht që nënkupton sjelljen e kryerësit nëse përmirsohet(resocializimi) dhe nëse e kalon minimumin e dënimit ka mundsi që të lirohet nga ku mund të themi se si rezultat i asaj që thash më lart se qëllimi i burgut është risocializimi del se përvec risocializimit qëllim tjetër është edhe neutralizimi që nënkupton se dënimi me burg është i vermi dënim që mund të shqiptohet në vend të dënimit me burg të përjetshëm.³⁸ Si zëvendësim i burgut shihen dënimet alternative dhe dënimi me të holla në pothuajse dy dekadat e fundit të shekullit të kaluar nga ku mendohet se personi i caktuar që kryen një krim e prish rendin shoqëror dhe se burgu është vetëm një masë qëshqiptohet me qëllim kinse të ndikojë të kryerësi dhe që ai të mos e përsëris të njëjtën, mirëpo qëllimi nuk është ndëshkimi por ndihma dmth qëatij ti afrohet nihmë dhe për këtë më e përshtatshme është një dënim alternativ apo një dënim me të holla.³⁹

³⁶ Vllado K., "Коменатр на Кривичниот Законик", 2016, f.416-417

³⁷ Vllado K., E drejta penale, 2010, f.495

³⁸ Vllado K., E drejta penale, 2010, f.499

³⁹ Vllado K., "Коментар на кривиниот законик", 2016, f.417

Mbi populimi i burgjeve është një faktor i rëndësishëm i icli duhet marur parasysh për të cilën shkaktari i vërtetë i këtij fenomeni nuk dihet mirëpo vlen të përmendet edhe fakti se shumica e gjyqtarëve nuk meren me këtë çështje sa i përket mbi populimit të burgjeve por gjithashtu edhe në të shumtën e rasteve shqiptojnë dënim me burg edhe për vepra për të cilat nuk është i nevojshëm burgu, prandaj siç e ceka më lart se dënimt alternative dhe dënimi me tëholla është ndoshta një zgjedhje e mirë, e rëndësishme është edhe mos efektiviteti i dënimt me burg kjo si rezultat i politikës së dobët nga ana e shtetit sa i përket kësaj fushe dhe që shpie deri te ky problem enorm. Dënimet e shkurta me burg janë një faktor i rëndësishëm që ndikojnë edhe në mbi popullimin e burgjeve nga shkakut se si zakonisht këta dënime shqiptohet për veprat kryesisht më të lehta psh dënim deri në 6 muajku si shembull konkret mu mund të përmendim kryerësit primar ndaj të cilave shqiptohet më së shumti këta dënime sipas së cilës ky lloj dënimi nuk do ketë efekt të dëshirueshëm pasi koha është shumë e shkurtër dhe mundësia për të pasur sukses ndaj këtyre është shumë e vogël duke marrë parasysh se edhe pse dënimi është i shkurtër as përsëri largohet nga familja nga miqët gjë e cila ndion psikikisht tek ai⁴⁰ dhe normal se ajo më e rëndësishmja këtu sa i përket matjes së dënimit është se gjykatësi këtu duke u bazuar edhe nga rezultatet nga praktika del se mer parasysh faktin se a janë të dorzuara të gjitha provat me anë të cilave gjyqtari mund të vendos për shqiptimin e masës së burgimit, duhet të meret parasysh koha të cilën kryerësi e ka kaluar në paraburgim e cila duhet ti llogaritet gjatë matjes së dënimit me burgim, duhet bërë siç e ceka më lartë edhe individualizimin e dënimit dmth mos i shqiptohet dënim tjetër nga ajo që është paraparë,⁴¹ meret parasysh koha se kur e ka bërë veprën mënyra si e ka kryer, mjetet me të cilat është kryer vepra meren(*corpora delicta*) të cilat meren nga ana e gjyqtarit përkatës të cilat evidentohen nga policia gjyqsore me anë të raportit, rrethanat lehtësuese, rrethanat rrënduese, a është primar a është recidiv, jeta e mëparshme e kryerësit ku meren parasyh edhe nent 32, 33, 34,35, 39 të Kodit Penal që paraqesin qëllimin e dënimit, llojin e dënimit për të cilat do flas në vazhdim të punimit, ligjshmërinësa i përket shqiptimit të dënimit ku kemi edhe dy fazakryesore: konstatimi i veprës penale dhe matja e dënimit ku gjykatësi gjithashtu mund të bëjë edhe zbutjen e dënimit.⁴²

Dënimi me të holla është kryesisht dënim që jepet për vepra të dënusheme deri në tre vite respektivisht është alternativë e burgut. Është një dënim juridiko-publik që nënkupton pagesën

⁴⁰Гордана Лажетиќ-Бужарпвска, "Алтернативи за затворот", 2003, Shkup, f.32-39-40

⁴¹ Vllado K., E drejta penale, 2010, f.535-559

⁴² Kodi Penal i RM-së, Gazeta Zyrtare nr.199/14 neni-32,33,34,35,39

enjë shume të caktuar ndaj shtetit pra nuk është kompensim ndaj të të dëmtuarit. E njehta nuk mund të trashëgohet apo të meret nga ndonjë person tjetër në rast konkret si vullnetar për pagesën e këtij lloj dënimi. Është dënim që shqiptohet në gjoba ditore kryesisht nga 5-360 gjoba ditore. Shqiptimi nga ana gjykatës bëhet duke marrë parasysh të ardhurat që ka personi ndaj të cilit shqiptohetpor duke marrë parasysh edhe antarët në familje e cila është shumë e rëndësishme nëse personi mban familje. Minimumi i gjobës ditore është një euro në kundërvlerë në denarë dhe masimumi 5000 euro në kundërvlerë në denarë. Kët vlen të përmendet edhe ajo se dënimi me gjobë duhet ta tangoj vetëm ta akuzuarin jo edhe familjarët tjerë të atij pasi në këtë raast nuk arrihet qëllimi sepse kjo i bie të jetë pagesë solidare pasi paguhet edhe nga antarët tjerë prandaj më e rëndësishme mendoj se është pagesa afatgjate e dënimit se sa pagesa në mënyrë të menjëhershme. Dënimi me të holla është dënim më i shkurt i cili si zakonisht shqiptohet për dënime më të vogla apo më të lehta dhe kryesisht për kryerës primar nga ku edhe mendoht se me anë të këtij dënimi do arrihet preventiva speciale dhe gjenerale dhe që kryerësi të mos e përrsëris të njejtën.⁴³ Dënimi me gjobëmund tëshqiptohet ose si dënm kryesor ose bashk me dënimin me burg. Kur shqiptohet si dënim kryesor kemi sistemin e gjobave ditore sistem i cili kryesisht bazohet në fajsinë e kryerësit ku meret parasysh mundësia pronsore dhe personale e kryerësit dmth dy elemnte janë të rrëndësishme: lloji i fajësisë mvarsisht prej veprës dhe gjendja pronsore. Sistemi i gjobave ditore është e përcaktuar vetem nga maximumi dhe mi minimumi i dënimit me të holla pra nuk është e përcaktuar se për 6 muaj burg psh do i jepen 10 gjjoba ditore. Gjatë shqiptimit të gjobës ditore gjykatësi do fillojë nga përgjegjsia, pesha e veprës penale dhe qëllimi i dënimit(neni 39 KP) rrethanat rrënduese dhe lehtsuese për lartësiën e gjobës ditore për matjen e dënimit, pra lartësia e gjobës ditore është një proces i rëndësishëm nga ku gjykatësi duhet të mar të dhëna për gjendjen pronsore dhe personale të kryersit kurse dënimi me gjobë bashk me dënimin me burg ose me dënimin me kusht shqiptohet shumë fikse e të hollave ku meren parasysh rregullat e prëgjithshme për matjen e dënimit, gjendja familare, të ardhurat.⁴⁴ Shembull konkret është kur gjykata do shqiptoj dënim me burg deri në 2 vjet dhe dënim me të holla deri në 30 gjoba ditore. Pagesa mund të bëhet nga 1 dit deri në tre muaj afat që e përcakton gjykata, mirëpo i njehti mund të shtyhet deri në dy vite për shkaqe objektive. Nëse pagesa nuk bëhet edhe në këtë afat gjyqi do reagoj me anë detyrimit për pegesë në mënyrë të dhunshme pra

⁴³ Vllado K., "Коментар на кривичниот законик", 2016, f. 430-432

⁴⁴ Vllado K., "Коментар на кривичниот законик", 2016, f. 433-435

nnërpmjet përmbartimit i cili afat nuk mund të jetë më i gjat se 3 muaj. Nëse përsëri i akuzuari nuk e paguan edhe në këtë afat atëherë dënimi me gjobë mund të zëvendësohet me dënim me burg nga ku çdo gjobë ditore do zëvendësohet me një dit burg kurse në rastet kur dënimi më të holla është shqiptuar bashkë me dënimin me burgim duke filluar nga 20 euro për çdo 20 euro do kemi zëvendësim me nga një dit burg burgim i cili nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj. Dënimi me të holla as nuk trashëgohet as mund të paguhet nga dikush tjetër por etëm nga personi ndaj të cilit i është shqiptuar dhe ky dënim mund të mos egzekutohet(paguhet) vetëm nëse personi vdes.⁴⁵ Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrimeve është dënim që shqiptohet së bashku me dënim me burgim apo me dënimin me kusht. Këtë ndalesë e shqipton gjykata ndalesë e cila nuk mund të jetë më e vogël se një vit dhe as më e madhe se gjashtë vite ku koha që personi e kalon në burg nuk llogaritet në ndalesë. Është dënim që shqiptohet çdo personi që ustron një veprimtari të caktuar apo qoftë edhe personave zyrtar që ushtrojnë një veprimtari të caktuar apo një profesion të cilat me përdorimin e profesionit apo veprimtarisë kryejnë veprë penale për përfitime të caktuara. Si shembull mund të përmendim një mjek i cili bën një abort ilegal duke i kundërshtuar kompetencat që ka dhënë ligji si mjek dhe duke marrë parasysh rrethanat në të cilat lejohet aborti.⁴⁶ Preventiva speciale këtu ka të bëjë me atë se ky ndalim bëhet me qëllim që të mos ketë personi i caktuar qasje me profesionin me qëllim që të mos e keqpërdot atë për përfitime personale me anë të kryerjes së një veprë të caktuar. Ndalesa administrative nënkupton mbylljen e objektit për shkak të vërtetimit të parregullsive ose marrja e lejes së koncesionit.⁴⁷

Ndalimi i drejtimit të automjetit shqiptohet si dënim dytësor së bashku me dënimin me burgim, dënimin me të holla dënimin me kusht apo vërejtjen gjyqësore. Shqiptohet edhe si dënim i vetëm apo kryesor për vepra të cilat dënohen me burgim deri në një vit apo dënim me të holla(vepra ku ka ndodhur edhe për shkak të viktimës) dhe në rast se nuk repektohet ndalimi do zëvendësohet me dënim me gjobë apo me burgim. Është dënim që u shqiptohet kryerësve të veprave penale të cilët me veprat e tyre e rrezikojnë jetën e të tjerëve në komunikacion dhe gjatë matjes së dënimit gjykatësi mer parasysh funksionin e saj retributiv sidomos kur shoqërohet me dënim me burgim apo me gjobë. Preventiva speciale nënkupton që gjykatësi gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh se personi për një kohë duhet të largohet nga trafiku pasi egziston mundësia e përsëritjes së veprës. Kemi edhe rastet kur personi është i dehur. Kjo masë mund të zgjasë nga 3 muaj deri

⁴⁵ Villado K, "Коментар на кривичниот законик", 2016, neni-38 а

⁴⁶ Villado K, "Коментар на кривичниот законик", 2016, f.441

⁴⁷ Villado K, E drejta penale, 2010, f.519

në 5 vite kurse për personat që meren me që vozitjen e kan profesion ndalimi është nga 1 vjet deri në 10 vite⁴⁸. Dëbimi i të huajit nga vendi është lloj dënimi që e zbaton gjykata ndaj të huajve kryesisht kur natyra e veprës, motivi i kryerësit dhe mënyra si është bërë vepra tregojnë se personi i caktuar është i padëshirueshëm. Ky dënim nuk vlen për personat që gëzojnë mbrojtje në përputhje me marveshjet ndërkombëtare që dmth edhe nëse zhvillohet gjykim ndaj personit që është nën mbrojtje nuk mund menjëherë të shpallet **non grata**.⁴⁹ Është dënim që shqiptohet së bashku me dënimin me burgim ose me gjobë, dënimin me kusht ose vërejtjen gjyqsore. Gjatë matjes së dënimit, gjykatësi karakterin retributiv e lidh me vet personin për ndonjë situatë të ndryshme. Meret parasyh gjithashtu edeh shtytja dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra , natyra e kryerësit dhe kjo si zakonisht bëhet për vepra të cilat nuk janë kryer nga pakujdesia (vepra të rënda) dhe si zakonisht kryerës këtu janë personat e huaj që sjan shtetas të RM-së. Mund të zgjasë nga 1 deri në 10 vite.⁵⁰ Ndalimi për pjesmarje në ndeshje sportive është dënim ëq dënohet nga 1 vit deri në 3 vite për ndeshjet sportive. U inkriminua në vitin 2014 si rezultat i përlëshjeve të shumta edhe pse si ligj bën kufizim të një aktiviteti njerzor ku cdokush mund të mar pjesë në një ndeshje por rrethanat jan të atilla që duhet një ligj i këtillë. Shtiptohet me dënimi me burgim, me gjobë, d.me kusht apo vërejtje gjyqsore dhei njejt ka rol represiv dhe preventiv. Duhet plotsuar tre kushte për shqiptim të këtij dënimi: nji-duht të bëhet fjalë për cfardo përlëshje qoft fizike apo psiqike. psh lendim trupor, dy-thamë se ka edhe rol represiv ehe preventiv dmth duhet shqiptuar para gjatë dhe pas ndeshjes dhe e treta kjo realizohet me nihmën e MPB-së dmth gjykatësi gjatë matjes së dënimit ka parasysh faktin kryesor nëse në ndeshjen e caktuar ka pas përlëshje apo jo, ka pas lëndime apo jo.⁵¹ Duke e ditur se në shoqëri kemi institucione, shkolla, universitete të cilat sipas terminologjisë juridike njihen me emrin persona juridik. Edhe personat juridik mund të kryerjnë vepër të caktuar penale për të cilën vepër bartin përgjegjsi duke mos e përjashtuar edhe përgjegjsinë për personin fizik si përgjegjës i personit juridik psh drejtori apo rektori si kryerës direkt të veprave penale. Për të njejtat vepra penale janë të paraparë edhe dënime për personat juridik edhe atë: dënime kryesore dhe dënime sekondare. Si dënim kryesor mund të përmendim dënimin me gjobë ndërsa si dënim sekondar mund të përmendim: marjen e lejes, marjen e licencës, ndalimi prë pjesmarje në thirje publike, ndalimi i lidhjes së kontratave

⁴⁸ Vllado K, E drejta penale, 2010, f. 520-521

⁴⁹ Kodi Penal i RM-së, Gazeta Zyrtare, nr. 199/14, neni 38-g

⁵⁰ Vllado K, "Коментар на кривичниот законик", 2016, f. 447

⁵¹ Vllado K, "Коментар на кривичниот законик", f. 448-449-450

për furnizim. Nëse bëhet fjalë për vepratë rënda ku mund të shkatrohet pasuria mund të shqiptohet edhe dyfishsi ikëtyre dënimeve. Gjatë matjes së dënimit nga ana e gjykatës i jept afat prej 15 deri në 30 që ta paguaj dënimin dhe nëse nuk e paguan dënimin atëherë shkon në procedurë përmbartuese por parat se të shkohet me anë të procedurë përmbartuese do meret parasysh nëse personi fizik në personin ka pasuri dhe nëse ka duhet të paguajë nga pasuria e vetë që e ka deponuar në momentin e themelimit të personit juridik pra nga kapitali investues ose në mënyrë solidarë nëse ka aksionar nga të gjithë aksionarët ose nëse kanë para jashtë shtetit mund të paguhet edhe nga ato para. Dënimit që i shqipton gjyqi ndaj personit juridik mund të zgjasin nga 1 deri në 5 vite. Gjyqi gjithashtu mund të shqiptoj edhe ndalimin e përkohshëm e ushtrimit të veprimtarisë ose ndalimin e përhershëm për ushtrimin e veprimtarisë. Të dyja shqiptohen së bashku me dënimin me gjobë dhe vlejné në rastet kur për veprën e kryer është paraparë dënim me burgim për personin fizik deri në tre vjet, i vetmi dallim është se të dyta shqiptohet për recidivët pra gjatë matjes së dënimit e rëndësishme është kapitali i personave juridik, veprimtaria, personi fizik dhe jeta e mëparshme e tij, lloji i veprës, arsyet pse e ka bërë të njëjtën.⁵²

Siç e cekim edhe në fillim të punimit tim se dënime alternative për herë të parë janë përmendur në dënimin me kusht si pjesë përbërëse e Kodit Penal të ish RSFJ-së në vitin 1951 duke marrë për baë dhe novelat e vonuara. Qëllimi i dënimeve alternative është që ndaj kryerësit të veprës penale kur bëhet fjalë për vepra më të lehta për të cilat është paraparë dënim deri në dy vjet apo dënim me të holla mund të shqiptohen dënimet alternative dhe kur mendohet se do arrihet qëllimi i dënimit me shqiptimin e dënimit me kusht apo vëretjes gjyqësore. Kemi 6 lloje të dënimeve alternative: dënimi me kusht, dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar, puna në dobi të përgjithshme, ndërprerja me kusht e procedrë penale, vëretja gjyqësore dhe burgu shtëpiak. Gjykatësi gjatë matjes së dënimit këtu mer parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit.⁵³ Pasi vendimi i gjykatës bëhet i plotfuqishëm atëherë ekzekutohen dënimet alternative nga organi për punë sociale që përbëhet nga persona profesionalë që emrohen nga Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve⁵⁴ Duke filluar nga dënimi me kusht i cili shqiptohet për vepra ku dënimi i paraparë është dy vite apo me të holla. Gjithashtu vlen të theksohet se egzistojnë dy sisteme ai angli sakson dhe ai euro kontinental ku sipas të parit me dënim me kusht nënkuptojmë suspendim

⁵² Vllado K, E drejta penale, 2010, f. 524-525-526

⁵³ Слаѓана Тасева, "Прирачник за полагање на правосуден испит", 2012, f. 258-269

⁵⁴ Afrim Osmani, "Komentari i ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale", 2013, Shkup, neni-226

të dënimit për një kohë të caktuar duke e vendosur nën mbikqyrje të dënuar kurse sipas të dytës nënkuptomë shtyerje të ekzekutimit të dënimit pa mos e vendosur nën mbrotjtje personin e dënuar. RM-ja ka sistem mix dmth është kombësim i të dy sistemeve. Gjykatësi gjat shqiptimit të këtij dënimi duhet të vlersojë se personi gjat kohës së kontrollit nuk do kryejë vepra të re penale.⁵⁵ Mund të bëhet edhe revokimi i dënimit me kusht. Revokimi mund të bëhet në tri raste: konstatohet se personi ka kryer vepra penale pas shqiptimit të dënimit me kusht, konstatohet se ka kryer vepra penale para shqiptimit të dënimit dhe mos plotsimin e obligimeve, dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar shqiptohet gjithashtu për vepra të cilat është i paraparë dënim me burg deri në dy vite ose dënim me të holla dhe që i njëjti mbikqyrës nga organi social. Qëllimi se pse ky dënim është me mbikqyrje është se personit që i është shqiptuar ky dënim mund të arrihet vetëm me mbikqyrje ose me ndihmë nga organi përkatës gjegjësisht nga organi social.⁵⁶ Ndërprerjen me kusht të procedurës penale e shqipton gjykata për dënimet për të cilat është paraparë dënim me burgim deri në një vit ose dënim me të holla. Ndërprerja e procedurës penale mund të ndërpritet max deri në një vit. Ndërprerja me kusht e procedurës penale mund të bëhet pasi është ngritur procedura. Këtu vjen në shprehje parimi i oportunitetit që nënkupton se në raste të caktuara prokurori mund edhe të mos ngrej procedurë kur kjo nuk është e nevojshme. Zbatimi i kësaj masë është i inspiruar edhe nga ideja për drejtësi restorative, pra kushti që të arrihet kjo është që të ketë pajtueshmëri nga ana e të dëmtuarit kurse nga ana tjetër kryerësi duhet të bëjë pendim për veprën e kryer dhe kryerësi duhet që brenda periudhës një vjeçarë derisa zgjat kjo të mos kryejë vepra të re penale dhe nëse e plotson këtë kusht atëherë do bëhet ndërprerja e procedurës penale,⁵⁷ puna në doli të përgjithshme shqiptohet për vepra për të cilat është paraparë dënim deri në tre vite burgim apo dënim me të holla. Shqiptohet duke marrë edhe pëlqimin e kryerësit. Puna në doli të përgjithshme kryesisht bëhet në organe shtetërore apo institucione pa pagesë e cila duhet të përfshi prej 40 deri në 240 orë të cilat mund të jenë kurdo qoftë nuk është e thënë fiks kur. Për shkaqe shëndetësore mund të shtyhet edhe për 6 muaj. Në rast se bëhet fjalë për dënim prej 3 muaj burgim apo 1800 euro gjobë kompensimi bëhet në mënyrë të atillë që për çdo tre orë që do punoj brenda 24 orëve do ndrohen me 20 euro dmth tre orë punë do vlejë 20 euro. Gjatë matjes së dënimit gjyqtari do mer parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese e sidomos jetën mëparshme të kryerësit, vërejtja gjyqësore është vendim që e bie gjykata për

⁵⁵Kodi Penal i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.199/14

⁵⁶ Vllado Kambovski, E drejta penale, 2010, f.570-572-573

⁵⁷ Vllado Kambovski, E drejta penale, 2010, f.575-576

vepra të lehta deri në një vit ose dënim me gjobë. Qëllimi këtu që të mos zbatohet dënim ndaj kryerësit po thjesht një paralajmërim kjo nga shkaku se kjo në vete nuk ka karakter retributiv. Mund të shqiptohet edhe për edhe për vepra që është parapaë dënim deri në tre vite (neni 130 i KP paragrafi i II sa i përket lëndimeve trupore që mund kryhen gjatë dhunës familjare). Para shqiptimit të këtij dënimi duhet marur parasysh personalitetin e kryerësit, jetën e maparshme të tij, sjellja pas kryerjes së veprës penale, shkalla e përgjegjësisë dhe burgu shtëpiak shqiptohet për vepra që dënohen me dënim deri në një vit burg apo dënim me të holla. Mund ta zëvendsojë dënimin me burg nëse ka kushte elektronike dhe për dallim nga burgu këtu është se burgu mbahet në shtëpi e jo nëpër institucione përmirësuese dhe duhet pikërisht këta rrethana të meren parasysh para zbatimit të këtij lloji dënimi dmth se a plotsohen kushtet elektronike, a ka mjete për kontroll të telefonit për personin që vendoset burgun ta kryejë në shtëpi.⁵⁸ Duke u bazuar nga të dhëna nga praktika gjyqësore si rezultat i praksës që kam ndjekur dhe me qëllim që të mar informacione se cilat dënime zbatohen më së shumti nga gjykatat tona me theks të veçantë sa i përket dënimeve alternative dhe matjes gjyqësore, mund të them dhe mund të konkludoj se duke u bazuar edhe në të dhëna statistikore të cilat do i paraqes në fund të punimit tim dhe të cilat gjithashtu do i elaboroj mund të them se nga të gjitha dënimet alternativ si dënim më i shprehur ishte dënimi me kusht, një dënim që shqiptoheshte shumë në krahasim me dënimet tjera alternative dhe në numër të vogël edhe vërejtja gjyqësore. Procedura penale ka dy faza: konstatimin e veprës penale dhe matjen e dënimit. Pasi konstatohet vepra penale në bazë të fakteve dhe provave që prokurori i çështjes i ka dorëzuar në gjykatë dhe pasi zhvillohet e gjithë procedura ku shohiten të gjitha faktet me anë të të cilave vërtetohet se personi e ka kryer veprën penale dhe pasi mbahen fjalimet përfundimtare, gjykatësi i çështjes automatikisht kalon në fazën e dytë ku duhet të bjerë vendim, vendim të cilin duhet ta arsyetojë dhe ajo me e rëndësishmja duhet të bëjë matjen e dënimit nga ku meret parasysh parimi i individualitetit dmth që dënimi të jetë adekuat dhe të përshtatet me veprën që kryerësi e ka bërë dmth as më pak as më shumë, matjen e dënimit në kornizat penale dhe jashta kornizave penale ku tek e para matja e dënimit brenda kornizave penale do e ket parasysh motivin që e ka shtyrë kryerësin ta kryejë veprën penale, intensiteti i kërcënimit dmth shkallën e rrezikshmërisë, rrethanat nën të cilat është kryer vepra (vendi, koha, mjete), kontributi viktimës (tek kontratat me fajde ku viktimat e lidh kontratën duke i ditur pasojat), jetë e maparshme e kryerësit sidomos nëse është recidiv do meret si rrethanë rrënduese,

⁵⁸ Villado K, "Коментар на кривичниот законик", neni 58-a, 58-b, 59, 59-a

rrethanat personale nga cila familje rrjedh, sjellja pas kryerjes së veprës dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese ku kemi qasje induktive-analizë e të gjitha rrethanave veçmas dhe qasje deduktive-analizë e rrethanave në përgjithsi dhe matja e dënimit jashta kornizave penale ku vjen në shprehje zbutja e dënimit dhe lirimi nga dënimi⁵⁹. Zbutja e dënimit është mundësi që ligji ia jep gjykatësit vetëm në ratet kur kjo lejohet. Kemi zbutje ligjore atë që ligji e ka përcaktuar se lejohet zbutja në raste të caktuara dhe gjyqësore kur gjyqtari vleron se egzistojnë rrethana lehtësuese për zbutjen e dënimit(vjedhja e barnave për shërimin e një të sëmurë). Nëse është paraparë dënim me 10 vjet burgim nëse bëet zbutje nënkupton 7 ose 8 vjet burgim dhe me anë të cilës mendohet të arrihet preventiva speciale dhe gjenerale e dënimit kurse me lirimi nga dënimi nënkuptojmë kur zhvillohet gjykimi, personi shpallet i fajshëm pot lirohet nga vuajtja e dënimit. Lirimi mund të jetë ose si falje ose si masë alternative, psh kur pjestari i grupit kriminel del nga grupi dhe i zbulon edhe antarët tjerë⁶⁰ Siç e përmenda më lartë se dënimet alternative janë dënime që në praktikën tonë gjyqsore zbatohen me të madhe duke marur parasyh se edhe punimi e kam pikërisht për dënimet alternative duhet ditur se nga praktika kanë aplikohen duke e ditur se edhe me ndryshimet e bëra në procedurën penale u futëm tre institute si procedurë sumare:sjellja e aktgjykimt në bazë të propozim marveshjes mes prokurorit dhe të akuzuart, mediacioni dhe urdhër dënimi dhe duke e ditur se këta zbatohen për vepra deri në 5 vite. Prokurorët e zbatojnë me të madhe urdhër dënimin për shqiptimin e dënimeve alternative duke e ditur edhe atë se për veprat deri në 5 vite gjykon gjykatës individual. Prokurori në praktikë si zakonisht jep propozim për zbatimin e udhërr dënimit për vepra si psh leëndime trupore të lehta që ndodhin në familje, për lëndime të rënda trupore sipas paragrafit 1. Gjykatësi i çështjes penale konkrete gjatë zbatimit të dënimeve alternative gjegjësisht dënimt me kusht dhe vërjetjes gjyqsore duhet të dije se me mos shqiptimi e dënimit efektiv- me burg a do arrihet qëllimi me anë të dënimeve alternative në përputhje me nenin 48, 48-a paragrafi 1, 49 paragrafi 1, 50 paragrafi 1 dhe 3 neni 59,⁶¹ preventiva speciale që dmth kryerësi të jetë me i kujdeshëm dhe të mos bëjë vepër tjetër penale duke mar parasysh revokimin e dënimit me kusht dhe zëvendësimin dënimit me kusht me dënim me burg dhe njëkohsisht do dënohet edhe për veprën e re penale kurse preventiva gjenerale që të ndikojë edhe tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjatë shqipimit të dënimit alternativ gjykatësi duhet ta merë parasyh nenin 32, 33, 34, 35 dhe nenin 39 që

⁵⁹ Villado K,E drejta penale,2010,f.537-539-543

⁶⁰ Villado K,E drejta penale,2010,f.549-551-552

⁶¹ Villado K,Kodi penal i RM-së,Gazeta Zytare nr.199/14,neni-48, 48-a, 49, 50, 59

janërregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si jeta mëparshme e kryerësit, rrethanat personale, shkalla e përgjegjesisë penale motivet, para matjes së dënimit gjykatësi duhet të ketë parasysh nëse vepra është bërë në mënyrë direkte apo indirekte, a është bërë kundër një personi apo kundër më shumë personave, a është bërë kundër bindje politike dhe fetare, gjinore, racore dhe ajo më e rëndësishmja gjykatësi duhet mbajtur llogari për lartsinë e dënimit që ja jep, pasojat dhe nevojat për resocializim.⁶²

2.4. Ligji për probacion

Është ligj i cili ka hyrë në fuqi më 25.12.2015 i me anë të së cilës rregullohen punët e probacionit dhe procedurës së ekzekutimit të dënimeve alternative si; dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar, punë në dobi të përgjithshme dhe burgu shtëpiak dhe njëkohsisht edhe procedurën për ekzekutimin e lëshimit me kusht, qëllimin e dënimeve alternative, nënpunësit e probacionit në ekzekutimin e masave alternative dhe detyrat respektivisht procedurën e mbikqyrjes. Dënimet alternative shqiptohen dhe ekzekutohen me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti dhe gjithashtu resocializmin dhe reintegrimin e personave ndaj të cilëve shqiptohet masat alternative. Punët e probacionit ekzekutohen nga persona respektivisht nënpunës që janë të e probacionit që të emruar nga Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve duke u bazuar në vendimin që e jep gjykata dhe pajtueshmërinë e kryerësit.⁶³ Punët e probacionit i zbaton Drejtoria nëpërmjet nënpunësve të cilat janë të shpërndarë nëpër të gjitha komunat ku janë edhe gjykatat kryesisht me kompetencë të zgjeruar dhe gjatë zbatimit të obligimeve të probacionit të gjitha organet shtetërore duhet të bashkpunojnë dhe ti ndihmojnë Drejtorisë për mbledhje të informacioneve të cilat janë të rëndësishme në kryerjen e punëve nga nënpunësit probativ. Drejtoria është organi që e bën mbikqyrjen duke u bazuar në udhëzimin e dhënë nga Ministri i drejtësisë me propozim të drejtorit për ekzekutimin e sanksioneve dhe për çdo komunë është përgjegjëse zyra e drejtorisë së vendit se ku personi jeton apo ku ka qëndrim. Nënpunësit mund të identifikohen nëpërmjet legjitimacionit legjitimacion të cilën e jep Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve. Marja dhe dhënia e legjitimacionit bëhet me nënshkrim të Ministrit por me propozim të Drejtorit për ekzekutimin e sanksioneve. Afati i legjitimacionit është 5 vite. Në rast se kalon afati,

⁶² Vllado K, Kodi penal i RM-së, Gazeta Zytare nr.199/14, neni-32, 33, 34, 35, 39

⁶³ Ligji për probacion, Gazeta Zytare, nr.226/15, neni-1, neni-2, neni-3

nëpunësi duhet ta kthejë atë tek tek Drejtori i cili e ka për detyrim që ti jap legjimitacion të ri.⁶⁴ Gjatë ekeikutimit të dënimeve alternative nga ana e nëpunësve të probacionit duhet të rrespektohen të gjiha të drejtat dhe liritë që i garantohen me kushtetutën e RM-së personi të vendosur në mbikqyrje, përjashtim janë vetëm rastet kur duhet të kryhen obligimet sa i përket mbikqyrjes. Nëpunësit duhet të punojnë duhet të kujdesen në mënyrë të paanshme dhe duke iu larguar cdo diskriminimi si fetar, racor, në bazë të ngjyrës, gjendjes shëndetsore, përkatsisë politike, përkatsisë nacionale, gjuhës, të arsimit dhe me ta duhet që të sillet në mënyrë njerzore se fundja njerëz janë panvarsisht se janë të dënuar me vendim gjyqsorë. Personi i vendosur në mbikqyrje i ka të drejtën e mbrojtjes shëndetsore e drejtë e cila i garantohet me anë të dispozitave dhe rregullave shëndetsore, i garantohet mbrojtja e personalitetit dhe sekretit, ka të drejtë ta shqyrtoj lëndën e vet, ka të drejtë të bëjë kundërshtim dhe për të cilin kundërshtim deri të Drejtoria për punën e nëpunësit probativ për të cilën nëpunësi duhet të përgjigjet në afat prej 3 ditësh kurse Drejtoria mund të përgjigjet në afat prej 8 ditësh për kundërshtimin e personit të vënë në mbikqyrje, mund të kërkoj ta ndroj vendbanimin qëndrimin sipas së cilës gjykatësi e ka dënuar. Mund të çoj lutje tek gjykata sa i përket ndryshimit të vendbanimit dhe e njëjta duhet në afat prej 8 ditësh ta informoj. Gjithashtu ka edhe regjistrë që Drejtoria e mban për evidentimin e personave që vendosen në mbikqyrje. I njëjti është elektronik i cili jepet me propozim të Drejtorit të drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve dhe sa i përket mbajtjes dhe udhëheqjes të njëjtën e nënshkruan Ministri.⁶⁵ Cdo person i vendosur në mbikqyrje ka tretmanin e vet tretman i cili është personal për çdonjërin dhe e njëjta kryhet nga nëpunësit probativ. Këtu përfshihen metoda, aktivitete të rëndësishme për mbikqyrje të personit dhe ri aftësimin e tij dhe njoftimin me pasojat që do i ketë në rast se nuk i plotson të gjitha. E rëndësishme është që të kryhen me sukses punët e një nëpunësi të këtillë siç janë: zbatim apo kryerje e mbikqyrjes që i është shqiptuar së bashku me dënimin me kusht nga ana e gjykatës, mbikqyrje gjatë punës në dobi të përgjithsme dhe mbikqyrje gjatë shfryzimit të aparateve elektronike për burgun shtëpiak si rezultat i dënimit të shqiptuar nga ana e gjykatës.⁶⁶ Kur gjykata do e shqiptojë dënimin me kusht me mbikqyrje të shtuar i njëjti vendim do i dorohet qendrës probative në komunën përkatse sipas vendbanimit në afat prej 15 ditësh. Pasi qendra do e mer vendimin është e detyruar në afat prej 15 ditësh ta

⁶⁴ Ligji për probacion, Gazeta Zyrtare, nr.226/15, f.2

⁶⁵ Ligji për probacion, Gazeta Zyrtare, nr.226/15, f.3,4

⁶⁶ Ligji për probacion, Gazeta Zyrtare, nr.226/15, f.5

përpiloj planin se si do zhvillohet mbikëqyrja. Para se të filloj ekzekutimi persni thiret për bisedë në zyrën respektivisht qenrën e probacionit, përcaktohet koha kur duhet të shkojë dhe bën kontrollimin e dokumentacionit dmth vendimin që e ka sjell gjykata. Nëse nuk paraqitet brenda 24 orëve qendra e mbikëqyrjes do e informoj MPB-në kurse në rast se policia nuk mund ta gjejë të njejtin brenda 24 orëve gjithashtu do e informojnë. Qendra e mbikëqyrjes vendos nëse ndaj personit nuk është më e nevojshme për të cilën e informon gjyqin. Mund ti jap propozim gjyqitqë tja ndroj masën apo të ja vazhdojë mirëpo nëse personi i vendosur në mbikëqyrje nuk u përmbahet rregullave atëherë e njëjta do e informoj gjyqin dhe ko kërkoj revokimin e ëddnimit me kusht me mbikëqyrje të shtuar.⁶⁷ Kur gjykata shqipton dënim alternativ punë në dobi të përgjithshme i njëjti vendim njëjt sikur te dënim me kusht me mbikëqyrje dho i dërgohet organit mbikëqyrës n afat prej 15 ditësh. Organi duhet ta informoj organin social, agjensionin për punsim dhe Ministrinë e Drejtësisë. Para ekzekutimit të dënimit drejtoria do e thir personin për bisedë, do bëj këqyrje të dokumentacionit përfshir këtu edhe vendimin gjyqsor mbikëqyrje e punës në dobi të përgjithshme punë e cila bëhte pa pagesë. Bëhet në cdo institucion, ndërmarje dmth kryesore është që të jetë person juridik. Se ku do ta bëjë këtë do e përcaktojë organi mbikëqyrës duke marur parasysh edhe aftësitë që i posedon personi. Më pas lidhet kontratë me personin juridik, përcaktohetn kushtet, ënyra se si do punojë, mjetet me të ilat do punojë, pushimete gjatë orarit, pushim ditor apo javor duke mos haruar edhe sigurimin që duhet Drejtoria tja siguroj. Mun të kërkojë ndërpreje të përkohshme për shkaqe shëndetsore, familare apo personale nga ku duhet të coj lutje të gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve dhe nga i cili mvaret se a do e lejoj a jo. Injejt mund të bjere vendim për vazhdim të punës në dobi të pergjitshme nëse vërteton se nuk egzistojnë pengesa dhe për të njëjtën bie aktvendim. Kundër aktvendimit është e lejuar ankesa deri të këshilli penal.⁶⁸ Kur gjykata bie vendim për shqiptimin e dënimit me burg shtëpiak e njëjta në afat prej 15 ditësh duhet të ja dorzoj zyrës për mbikëqyrje e cila duhet ta pregatis planin paraprak dhe tretmanin që do ee zhvillojë me personin e vënë në mbikëqyrje. Nëse gjyqi i shqipton burgim shtëpiak me mbikëqyrje elektronike kompetente në këtë rast është zyra për probacion pasi edhe e njëjta i posedon të gjitha paisjet e duhura për mbikëqyrje elektronike. Personi i vënë në mbikëqyrje nuk duhet të dalë jasht ambientit të shtëpisë pasi gjyqi ka vendosur në mëyrë të tillë me anë të vendimit gjyqsor por gjatë ditës mund maximum deri në dy orë tëdalë

⁶⁷ Ligji për probacion, Gazeta Zyrtare,nr.226/15,neni 13 deri te neni 16

⁶⁸ Ligji për probacion, Gazeta Zyrtare,nr.226/15,neni 17-24

jasht ambientit të shtëpisë se ku jeton. Zyra për probacion ndihmohet ehe nga Ministri e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë. Rastet kur personi mund ta lëshoj ambientit ku jeton janë në rast të dhënies së provimit, kurorëzimit dhe shërimit pra shkaqe shëndetsore. Rastet kur ndërpritet dënimi me burg shtëpiak janë rastet e mesipërme që i përmende psh shkaqe shëndetsore dmth personi që në fillim dënimit sjtqpiak e ka vuajtur në organet shëndetsore dhe nëse ka qëndruar më shumë se 15 ditë automatikisht do ndërpritet procedura.⁶⁹ E gjithë kjo që foli deri tani ishte pjesa materiale dmth se si është e paraparë me ligj që të zbatohen dënimet alternative mirëpo nëse bazohemi në praktikë është krejtësisht ndryshe nga shkak se ky ligj ka ngelur vetëm në letër pra është vetëm një copë letër e pa grisur e cila nuk zbatohet. Kush është e vërteta për sistemin për mbikëqyrje elektronike me hallkë për të cilën shtrohet pyetja se a do kishte ikur ish kryeministri Nikolla Gruevski sikur të kishte kështu hallkë në këmbë sistem i mundësuar për funksionim me ligjin për probacion. Ende nuk ka hallkë me GPS, Spasovski duhet të ruaj Mijallkovin Kamçevin dhe Janakieskin 24 orë në ditë të mos ikin sipas disa mediave në Republikën Maqedonisë. Krejt kjo pasi gjykata me propozim të PSP-së të njëjtit i lëshoj duke u shqiptuar burgim shtëpiak. Sa u përket hallkave për mbikëqyrje elektronike ka, por të gjitha qëndrojnë në depotë e Drejtorsë për ekzekutimin e sanksioneve. Shtrohet pyetja sikur të kishte hallka a do duheshte MPB-ja të njëjtit ti ndjekë? Sipsa përgjegjësit të Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve që thekson se hallkat janë fiks të këtë qëllim për burgim shtëpiak dhe kjo është e mundur ngas shkak se mundsohet nga ligji për probacion. Hallka mbahet 24 orë në ditë dhe e njëjta është e qëndrueshme edhe ndaj ujit. Në Drejtorinë për ekzekutimin e sanksioneve janë gjithsej 400 copë të depozituara por të njëjtat nuk përdoren. Hallkat shkojnë bashk me një aparat ku vendose kartela me një aparat tjetër ndihmës. Pajisjet janë të blera që nga viti 2015 kur edhe u soll ky ligj dhe të njëjtat kishin 1 vjet garancion. Pajisjet janë mirëmbajtur nga një firmë e caktuar mirëpo problemi është se pajisja nuk është vënë në funksion. Afati është vazhduar plus edhe një vit(pro bono), por me ardhjen e drejtorit të ri pro bono nuk mundeshte se për të njëjtat firma ku ishin blerë më parë kërkonte kompensim. Problemi tjetër që u hap ishte problemi sa i përket prokurorit publik sa i ëq ka të bëjë me shpallje për mirëmbajtjen e të njëjtave pajisje e cila nuk ishte e përcaktuar me ligj.⁷⁰Në fillim të vitit 2019 pritet të rregullohet problemi me

⁶⁹ Ligji për probacion, Gazeta Zyrtare,nr.226/15,neni 25 deri te neni 30.

⁷⁰<https://www.alsat-m.tv/emisionet/emisioni-360-grade-14-01-2019/>

prokurorimin publik sepse në fillim të vitit 2019 sigurohen mjetet për mirmbajtjen e pajisjeve.⁷¹ Deri tani nuk është shqiptuar asnjë dënim me burgim shtëpiak edhe pse sipas Këshillit të Evropës burgjet janë të stërm bushura, domimon mbipopullimi nëpër burgjet e Maqedonisë. Po të përmenden rastet e fundit që ndodhën në shtet, kemi psh rastin e këngëtarit të operas Igor Drullovski si protesutues në natëne 27 prillit si dhe Elena Docevska Bozhnivoska nga kabineti i ish kryetarit të Parlamentit Trajko Veljanovski Gjykata Penale Shkupi 1 me propozim të Prokurorisë për ndjekje të krimit të organizuar u shqipton masën e paraburgimit ua zëvendëson me **paraburgim shtëpiak** pasi shumica mendojmë se bëhet fjalë për **burgim shtëpiak** dhe rastin e deputetes së VMRO-DPMNE-së Zhaklina Peshevska ku edhe këtu me propozim të prokurorisë për krime të rënda i hiqet dënimi **paraburgim shtëpiak** jo **burgim shtëpiak** dhe i shqiptohet masa e parandalimit që dmth të mos e lëshoj vendbanimin, koh pas kohe të paraqitet te organi kompetent respektivisht gjykata, marja e përkohshme e dokumentave të udhëtimit dhe nxjerja e dokumentave të reja dhe ndalimi për kontakt me persona të caktuar⁷², rast tjetër të paraburgimit shtëpiak kemi edhe me të dënuarit Sasho Mijalkov dhe Bedredin Ibrahimi pasi të njejtit u dënuan njëir me 3 vite burg a tjetri me 4.5 vite burg dhe deri në plotfuqishmërinë e dënimit ndaj tyre me propozim të PSP-së u shqiptua **paraburgim shtëpiak** pra burgim shtëpiak jo burgim shtëpiak për manipulime në zgjedhje lokale e cila është masë siguroese njejtë si paraburgimi mirëpo e njejtja mbahet në shtëpi, pra **burgim shtëpiak** nuk është shqitur edhe një herë të vetme. Të njejtën do e elaborojë me një tabelë në fund të punimit si shtojcë.⁷³

Pajisjet janë mjete që funksionojnë me mjete të siguruar nga Bashkimi European dhe të njejtat vendosen në këmbën e të dënuarit dhe e njejtja përçon sinjale deri tek aparati fiks që është i lidhur me sitemin qëndror. Nën punësit e probacionit e kontrollojnë çdo lëvizje që e bën personi i vënë nën mbikëqyrje që është e përcaktuar edhe me ligj dhe me anë të aparatit vërtetohet se personi a lëviz sipas radiusit të lejuar. Nëse paraqitet fotografi e keqe dmth personi nuk vepron sipas udhëzimeve, bën shkelje të asaj që është e përcaktuar sipas ligjit përkatës. Shkelje nënkupton dëmtim të pajisjes, arratisje. Nën punësit duhet të reagojnë në mënyrë të shpejtë nëse nuk marrin sinjal kthyes në të kundërtën e kontaktojnë në mënyrë automatike Ministrinë e Punëve të Brendshme. Sipas ligjit për probacion, arresti është masa më e rreptë alternative e paraparë me

⁷¹<https://www.alsat-m.tv/emisionet/emisioni-360-grade-14-01-2019/>

⁷²<https://sdk.mk/index.php/makedonija/durlovski-vo-kuken-pritvor-za-pratenichkata-peshevska-poblazi-merki-na-pretpazlivost/>

⁷³<https://sitet.com.mk/>

Ligjin mbi probacionin. Ligji përfshin edhe programën individuale për resocializim(e përmendur në ligjin për probacon të shjeguuar më sipër). Nënpunës të këtillë të probacionit ka por punë nuk ka. Departamenti i probacionit ka tre hapsira në Gjykatën themelore Shkupi 1-godina e re. Janë hapur edhe në Kumanoë, Tetovë, Ohër, Manastir, Prilep, Veles, Shtip dhe Strumicë. Githsej ka 11 zyra. Në rradhë janë edhe Koçani dhe Gostivari. Kryeqendra është e vendosur në Shkup kuptohet pasi është edhe kryeqytet. Ka vetëm 3 nënpunës, gjithsej janë 25 në përgjitsi të shpërndarë. Kontakt me të gjykuar nuk kanë. Vitin e kaluar u ndanë 1 milion euro nga IPA fondet për Tving projektin. Sipas nënpunësve të probacionit e dobishme do ishte edhe puna në dobi të përgjithsme, si psh nëse një stomatolog bën vepër penale në fushën e komunikacionit të shqiptohet puna në dobi të përgjithshme sipas së cilës për veprën e kryer penale i njeiti të va kontrolloj dhëmbët pampagesë fëmijëve në shkolla fillore. Sipas Gjykatës themelore Shkupi 1 ligji për probacion është ligj i ri, ka mungesë të disa kushteve tjera teknika dhe kjo nuk është kompetenecë e gjykatës të vendos për kushtet teknike. Shembull ideal mund të përmendim Norvegjinë e cila bëri reforma në sitemin e burgjeve ku gjithashtu recidvizmi ishte diku rreth 60 % kurse tash me zbatimin e mbikëqyrjes elektronike recidvizmi ka rrënie nga 60 në 20 %. Duke e ditur edhe gjendjen e parabugimeve do ishte shume e dobishme sikur të zbatoheshte edhe për paraburgimet a pasi edhe gjykatëst i ikin zbatimit të arrestit shtëpiak.⁷⁴Sipas një statistike të bërë në vitin 2013 diku ishin rreth 770 persona të vendosur në paraburgim kurse prej 770 personave shum pak ishin nën arrest shtëpiak. Padyshim se arresti shtëpiak është masa më e rreptë e paraparë sipas ligjit mbi probacion por nga praktika shum raste ka pas dhe ka kur personat lëngojnë nga ndonjë sëmundje e ndryshme(kanceri apo sëmundje të zemrës) dhe shumë persona gjatë paraburgimit përjetojnë atack cardiac si rezultat i kushteve mesjetare dhe asnjë nga institucionet nuk mer asnjë masë që paraburgimi të zevendësohet me burgim shtëpiak. Pse e gjithë kjo rrëmujë dhe vuajtje nga ana e qytetarëve të cilët në raste të caktuara mund të bëjnë veër penale të lehtë nga ku mund të shqiptohen dënime alternative?! E gjitha sepse nuk ka mënyrë se si të shqiptohet arresti shtëpiak por ska edhe siguri sa i përket zbatimit dhe respektimit të kësaj mase nga personat që vihen në mbikqyrje. Sikur të kishte arrest shtëpiak për ish kryemnistin Nikolla Gruevskin ndoshta edhe nuk do ikte duke u bazuar në ligj mirëpo nga rezultatet e deri tanishme edhe njëherë mund të vërtetetojmë se nga ana praktike jemi treguar dhe jemi ende të pasuksesshëm dhe ndoshta nuk do kishte konfrontim mes Prokurorisë Speciale

⁷⁴<https://www.alsat-m.tv/emisionet/emisioni-360-grade-14-01-2019/>

Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme respektivisht zhgënjim i MPB-së nga PSP-ja për largim të përgjegjesisë në rast arratisje edhe të personave që aktulisht janë në paraburgim shtëpiak!!⁷⁵ Duke shikuar nga ngjarjet që ndodhin çdo ditë në vendin tonë, me të vërtetë jemi mjerim sa i përket funksionimit të ligjeve pikë së pari më pas edhe pushtetin gjyqsor i cili është i kapur nga politika. Ajo që është më e çuditshme në gjithë këtë proces është fakti se si mund ka kluar gjithë ajo kohë që kur janë nxjerrur të ashtuquajturat "bombat" e opozitës, bomba që u dëgjuan në të gjithë ballkanin dhe në Europën perëndimore dhe duke pasur një pasqyrë të qartë mbi të gjitha abuzimet që janë bërë me paratë e qytetarëve, keqpërdorime detyrash, larje parash e shumë malverzime të tjera, si mund që duke i pasur gjithë këta dëshmi mos ketë asnjë vendim përfundimtar duke mos haruar pa përmend edhe rolin e PSP atë që do i kthenin tërë ata para dhe që do dënonin çdonjërin politikan që kishte bërë keqpërdorime.

Si shembull konkret real bazuar nga përditshmëria jonë është se si një qytetatar i komunitetit rom vetëm pse ka vjedhur 3 radiatorë nga një firmë private e Shkupit dhe të njëjtat i ka shitur në një qendër për grumbullimin e hekurit të vjetër nga ku Gjykata Themelore Shkupi 1 e ka dënuar me 1 vit e 8 muaj burg kurse nga ana tjetër ish ministrja e kulturrës Elizabeta Kamçevska-Milevska si bashkpuntorja më e ngushtë e Nikolla Gruevskit në realizim të projektit Shkupi 2014 bëri keqpërdorim të 400.000.00 milion eurove të cilat para ishin të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë për ndërtimin e statujave, godinave dhe dhe figura të shumta të kafshëve dhe maqedonëve në automatikisht paraqet vepër penale keqpërdorim dhe shumë vepra tjera pa mos haruar edhe bashkpuntorët tjerë njëjt funksionarë nga e njëjta parti politike dhe shumë biznesmenë të afërt të pushtetit nuk ka edhe një ditë burg por e njëjta bashk me deputet tjerë për shumë krime tjera u amnistuan me qëllim votimi për ndryshimet kushtetuese, apo mos harrojmë edhe Orce Kamcev i cili u lirua nga Gj. Supreme pasi PSP-së i kishte skadur afati dhe i shqiptohet paraburgim shtëpiak me propozim të PSP-së. Nuk është kjo drejtësia që ne prisnin.

2.5.Llojet e dënimeve në Republikën e Shqipërisë-dënimet alternative

Bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë respektivisht Kodit Penal kemi dy lloje të dënimeve: dënime kryesore dhe dënime plotsuese. Si dënime kryesore janë: dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Ndërsa si dënime plotsuese kemi disa lloje: ndalimi i së drejtës për të ushtruar funksione publike, konfiskimi i mejteve me të cilat është kryer

⁷⁵<https://www.alsat-m.tv/emisionet/emisioni-360-grade-14-01-2019/>

vepra penale dhe mjeteve të fituara nga vepra penale, ndalim i drejtimit të automjeteve, marja e titujv dhe dekoratave, heqja e së drejtës për ushtrimin e një veprimtarie apo mjehshtërie të caktuar, heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridik, nxjerja jashta teritorit, humbja e përgjegjesisë prindërore. Në rastet kur gjykata vleron se shqiptimi i dënimit kryesor nuk është e nevojshme pra çmohet si e papërshtatshme dhe për të cilat është parapar dënim deri në 3 vite, do shqiptojë dënim plotsues. Dënimi me burgim të përjetshëm njëjt si në legjislacionin tonë jepet për vepra apo krime të rënda, dallimi i vetëm është nuk u shqiptohet personave që ende si kanë mbushur 18 vjet dhe grave kurse në Kodin Penal të RM-së dënimi me burgim të përjetshëm mund tu shqiptohet vetëm personave që i kanë mbushur 21 vjet. Dënimi me burgim zgjatën nga 5 ditë deri në 35 vjet për dallim nga sistemi jonë i cili është nga 30 dit deri 20 vjet.⁷⁶ Kemi edhe kundërvajtjet penale të cilat në vete përfshin dy lloje të dënimeve: dëimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Kundërvajtjet penale janë vepra penale të cilat dënohen deri në dy vite burgim dhe të cilat njëjtë mund të zëvendsohen me dënime alternative që ne Republikën e Shqipërisë njihen si alternativat e burgut. Quhen kundërvajtje penale nga shkaku se në Republikën e Shqipërisë kemi dy lloje të veprave penale, sistem dualist: vepra penale dhe kundërvajtje, pra njëjt si Republika e Maqedonisë. Dënimi me burgim dhe më burgim të përjetshëm mbajet në institucione të posaçme. Të miturit e vuajnë dënimin në burgje tjera për dallim nga të rriturit, gjithashtu edhe grat janë të vendosura me gratë pra në shtëpi tjetër korektuese për allim nga meshkujt gjë që është e logjikshme dhe mendoj se çdokush e dinë njëinformacion të këtillë. Si dënim kryesor është gjithashtu i paraparë edhe dënimi me gjobë e cila paraqet pagesën apo dhënien e një shumë të caktuar shtetit shumë e cila është e paraparë me ligj. Gjoha jepet edhe për krime edhe për kundërvajtje penale. Për personat që kryejnë krime gjykata jep dënim me gjobë prej 100.000.00 mijë lek gjer në 10.000.000.00 milion lekë, për personat që kryejnë kundërvajtje penale gjykata jep dënim me gjobë prej 50.000.00 mijë lek gjer në 3.000.000.00 milion lekë. Pesonat që kryejnë krime për përfitime materiale gjykata vendos sipas nenin 36 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë-konfiskimi i mjeteve me të cilat është kryer vepra penale dhe dhe konfiskimi i mjeteve të cilat janë fituar nga vepra penale apo si rezultat i veprës penale, në rast se mjete të këtilla nuk ka pra mjete me të cilata është kryer vepra penale dhe mjete të fituara nga vepra penale ather gjykata respektivisht gjykatësi do zbatojë dënimin me gjobë prej 100.000.00 mijë leke deri në 5.000.000.00 milion lekë. Gjykatësi para se

⁷⁶<http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf>

të shqiptojë dënimin me gjobë, duhet të mar të dhëna për personin sa i përket gjendjes financiare, ekonomike, materiale dhe nëse gjendja e personit është e atillë sa që ai mund të paguajë dënimin, mund të shqiptohet dënimi me gjobë. Në raste të caktuara lejohet edhe pagesa e gjobës me këste kur mendohet se është e nevojshem çdoherë duke u bazuar në gjendjen dhe mundësinë për pagesën e gjobës. Afatin e përcakton gjykata. Në raste kur pagesa e gjobës është krejtësisht e pamundur atëherë ajo zëvendësohet me burg ku një ditë burg zëvendësohet me 5.000.00 mijë leke. Në raste ekstreme kur mos pagesa e gjobës justifikohet afati mund të shtyhet edhe për 6 muaj ose zbatimi i dënimit alternativ puna në interes publik. Nëse gjyba nuk paguhet ehe pas shtyerjes së afatit për 6 muaj dhe dhënien e mundësisë alternative atëherë zëvendësohet me burg.⁷⁷

Kur gjykata së bashku me dënimin me burgim shqipton edhe dënim plotsues, zbatimi i tyre fillon së bashku me dënimin kryesor. Përveç dënimëve si: ndalimi për të ushtruar funksione publike, ndalimi për të derjtuar automjete, heqja e së drejtës për ushtrimin e një veprimtarë ose mjeshtërie, heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personi juridik dhe ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative zbatimi i të cilave fillon pasi mbaron vuajtja e dënimit me burg. Kemi edhe masa mjeksore dhe edukuese që janë dy llojëshe: mjekim i detyruar ambulator dhe mjekim i detyruar në institucion shëndetsor. Afati është 1 vit, pas kalimit të afatit gjykata duhet të mbajë seance sa i për shqyrtimin e suksesit të këtyre masave.⁷⁸ Sa i përket dënimëve alternative nuk ka një kriter fiks siç është tek ne e përcaktuar se dënimet alternative jepen për vepra për të cilat është paraparaë dënim me burgim deri në 2 vjet dhe koha e mbikëqyrjes është nga 1 deri në 5 vite mirëpo në Republikën e Shqipërisë është e përcaktuar në mënyrë të tillë që dënimet alternative shqiptohen për vepra kryesisht të lehta dhe nuk është e paraparaë një numër 2 apo 3 vite burgim që të shqiptohet alternativa e burgut. Si të tilla, dënimet alternative që në Republikën e Shqipërisë njihen si alternativa e burgut i kemi 5 llojëshe: copëzimi i dënimit me burgim apo gjysmëliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim ose dënimi me **kusht(probatio)** si quhet në vende tëndryshme dhe në RM, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e punë në interes publik, lirimi para kohe me kusht dhe qëndrimi në shtëpi apo burgu shtëpiak sipas terminologjisë sonë e cila është një risi në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë me ndryshimet e bëra në 2008. Copëzimi i dënimit apo gjysmëliria paraqet sanksion penal alternativ që gjykata e shqipton ndaj

⁷⁷<http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf>

⁷⁸<http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf>

kryerësit të vepës penale duke marrë parasysh rrethanat familjare, arsimore, profesionale ose për aftësim mund të bjr vendim për trajnim ose rehabilitim mjeksor për kryerësin për vepra për të cilat është paraparë dënim deri në 1 vjet. Kushtet për shqiptimin e kësaj mase janë se: kjo masë shqiptohet ndaj kryerësve të penalisht përgjegjës për veprën e kryer, shqiptohet për vepra penale ose kundërvajtje për të cilat është paraparë dënim deri në 1 vjet, për shkae të rrënda familjare, arsimore, profesionale e cila ekzekutohet në mënyrë të copëzuar dy ditë në jave e cila mund të zgjas 3 vjet. Ekzekutimi është i tillë që pasi gjykata bie vendim, vendimi i dërgohet prokurorit, prokurori i cakton trajtimin dhe ja dërgon policisë dhe policia e njofton. Në rast se nuk u përmbaet rregullave të përcaktuara nga gjykata, vendimi mund të revokohet.⁷⁹ Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim(dënimi me kusht) shqiptohet është sanksion alternative që gjykata e shqipton në procedurë gjyqsore për veprat me rrezikshmëri të pakët prë të cilat është i paraparë dënim me burgim deri në 5 vjet dhe personi vihet në provë dhe gjatë kohës së provës nuk guxon të bëjë vepër penale e rëndë njëjt si vepra e kryer ose më të rëndë se ajo. Kemi 3 sisteme: sistemin anglo-sakson ku për herë të para përdoret termi **probatio** e cila përdoret në Angli dhe sipas së cilës kryerësi shpallet fajtor mirëpo nuk bëhet ekzekutimi i dënimit por njëkohsisht vendoset mbikëqyrje mbi personin, sipas sistemit të dytë dënimi shqiptohet por i njëjti pezullohet dhe dallimi është së nuk vendoset mbikëqyrje dhe sistemi i tretë është sistem mix ku ka elemente edhe nga e para edhe nga e dyta. Kushtet për shqipimin e këtij dënimi janë: pezullimin e dënimit e bën vetëm gjykata në procedurë të rregullt gjyqësore, u shqiptohet prsonave që janë të përgjegjës penalisht, shqiptohet për vepra për të cilat është paraparë dënim deri në 5 vite burim, shqiptohet vetëm për vepra të lehta dhe afati i mbkëqyrjes apo provës është 18 muaj. Gjate shqiptimit të këtij dënimi duhet të ketë paraasyh personi se:nuk guxon të pijë pije alkoolike, nuk guxon të drejtojë automjetin, nuk guxonë të takohet me persona të caktuar kryesisht të dënuar më parë, nuk guxon të shkojë në vende të caktuara. E ka për obligim të jetë i disiplinuar, ta dijë se i është shqiptuar dënim alternativ dhe duhet ti respektoj kushtet që ja ka vendosur gjykatësi, ta infomormojë shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve, ta infomojë shërbimin e provës për ndrimin e vendbanimit dhe duhet tu përgjigjet organeve për mbikqyrjen e provës si prokuroria, policia.⁸⁰ Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e punës së interes publik është dënim alternativ që e shqipton gjykata në procedurë të

⁷⁹ Bajram Ukaj, "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë",2006,f.299 deri 302

⁸⁰ Bajram Ukaj, "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë",2006,f.302 deri 308

rregulltë gjyqsore ndaj kryerësve penalisht të përgjegjshëm për veprën penale dhe si zakonisht shqiptohet në rastet kur është paraparë dënim me burgim deri në 1 vjet, për veprat që nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë dhe që gjykatësi në rastin konkret duke marrë paqrashtyri gjithë rrethanat që e bëjnë këtë vepër jo të rrezikshme, bën pezullimin e egzekutimit të dënimit me burgim dhe shqiptohet puna në interes publik e cila bëhet me pëlqim të kryerësit dhe është në natyrën humane dhe demokrate të së drejtës penale. Kushtet për tu shqiptuar ky dënim janë si në vijim: duhet gjykatësi konkret ta mer parasysh sjelljen para dhe pas kryerjes së veprës penale, a ka harmonizim të marrëdhënieve mes tij dhe të dëmtuarit, gjykata e shqipton këtë dënim për një kohë prej 40 deri në 240 orë punë pra e ngjajshme me RM-në, mund ta shqiptoj për vepra për të cilat është parapa dënim deri 1 vjet dhe gjykatësi duhet të marrë parasysh motivin e kryerjes së veprës, a ka pasur provokim nga i viktimja, mjetet me të cilat është kryer vepra penale dhe është e rëndësishme të përmendet edhe revokimi i punës në interes publik nëse personi bën vepër tjetër penale të rëndësishme s' vepra e kryer apo më të rëndësishme se ajo ose nëse nuk u përmbahet rregullave të përcaktuara nga ana e gjykatës dhe mund të themi se qëllim kryesor është që të personi të mos shkojë në burg e cila është me karakter retributiv⁸¹ Lirimi me kusht shqiptohet në rast se personi e ka mbajtur veçse një pjesë të dënimit dhe me sjelljen e tij dhe me punën e tij ka treguar se ajo pjesë që e ka vuajtur në burg ka ndikuar te ai dhe se është arritur qëllimi dhe kushti kryesor është që personi për pjesën tjetër që nuk do e kalojë në burg duhet të mos kryejë vepër tjetër penale të ngjajshme me veprën e kryer ose më të rëndësishme se ajo, kjo nënkupton se kryerësi duhet të vetdijsohet, duhet të ndërgjegjsohet dhe të respektoj kushtet e të mos kryejë bepër penale. Si kushte kryesore janë :sjellja e mirë gjatë vuajtjes së dënimit, të ketë vuajtur jo më pak se gjysmën e dënimit për kundërvajtje penale dhe jo më pak se dy të tretat e dënimit për krimet me dënim deri në 5 vite dhe jo më pak se tre të katërtat e dënimit për krime me dënim nga 5 deri në 35 vite burgim. Revokimi bëhet vetëm në rastet kur personi gjatë gjatëafatit të kushtëzuar kryen vepër tjetër penale,⁸² qëndrimi në shtëpi shqiptohet për vepra deri në 2 vjet burgim ose nëse nga një dënim më i gjatë i kanë ngelur vetëm edhe dy vite mund të shqiptohet ky dënim i cili mund të mbahet në shtëpinë e të dënuarit, ndonjë shtëpi tjetër apo në ndonjë institucion të kujdesit. Shqiptohet për: gra shtatzëna ose nëna me fëmijë nën 10 vjeç, për baballarët me përgjegjësi prindrore për fëmijët nën 10 vjeç, për persona në kushte të rënda shëtesore, për persona mbi 60

⁸¹ Bajram Ukaj, "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë", 2006, f. 312 deri 316

⁸² Bajram Ukaj, "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë", 2006, f. 316, 317, 318, 320

vjet. Mund të revokohet nëse nuk egzistojnë kushtet për këtë lloj dënimi. Gjatë matjes së dënimit gjykata duhet të ketë parasysh këta rrethana: rrethanat lehtësuese (personi paraqitet pas kryerjes së veprës), rrethanat rënduese (keqpërdorim i detyrës zyrtare), ulja e dënimit ose mos vuajtja e dënimit për bashkpuntorët e drejtësisë dhe viktimat, ulja e dënimit nën minimumin ku vlersohet se vepra nuk paraqet rrezikshmëri të lartë.⁸³

Duke e dtur se kushtetuta është akti më i lartë juridik brenda një shteti në nenin 116 përcakton hierarkinë e normave dhe në këtë nen përcaktohen mardhëniet ndërkombëtare të ratifikuara . Hartuesit e dënimeve alternative janë përpjekur që ti përshtatin këta dënime me mardhëni ndërkombëtare. Nuk duhet haruar pa e cekur edhe se Kodi penal që nga 1996 është ndryshuar shumë herë dhe deri në vitin 2008 kishim 7 lloje të dënimeve alternative ku dënimi me gjobë, zhdëmtimi i dëmit dhe ulja e dëniit nën minimumin janë hequr kurse është shtuar edhe një qëndrimi në shtëpi (arresti shtëpiak) dhe tani gjithsej ka 5 dënime alternative për dallim nga RM-ja e cila i ka të parapara 6 dënime alternative në Kodin Penal.⁸⁴

⁸³<http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf>

⁸⁴ Luan Omari, Aurela Anastasi, "E drejta kushtetuese", 2017, Tiranë, SHTËPIA BOTUESE "Dajti 2000", vështrime të përgjithshme, neni-116

KAPITULI I III

Dënimet alternative të RM-së në raport me dënimet alternative të Mbretërisë së Bashkuar-aspekti krahasues dhe matja e dënimit

3.1. Sanksionet penale dhe dënimet alternative në Mbretërinë e Bashkuar-karakteristikat

Duke e ditur se kemi një sistem të komplikuar të drejtësisë në Mbretërinë e Bashkuar, mund të përmendim se baza për vërtetimin e një krimi është **actus reus**(akti i fajsisë)-element fizik i kryerjes së krimit, **mens rea**(gjendja psikike)-element psikik që ka të bëjë me qëllimin e veprës, pra pse një vepër e caktuar kryhet dhe **strict liability**(neglizhenca)-nënkupton se jo çdo akt(veprim) ka mens rea(elementin psikik), p.sh vozitja në gjendje të dehur paraqet neglizhencë nga shkaku se e dim se edhe në sistemin tonë kemi **actio libera in causa**(vendime të lira në veprim por jo edhe në kryerje) dhe e dim se kjo nënkupton se personi para se ta sjellë veten në gjendje të papërgjegjshme duhet të ketë qenë i vetdijshëm para se të konsumoj alkool narkotik apo substanca tjera, për dallim nga Mbretëria e Bashkuar që përfshin vetëm alkoolin dhe pasi është e ndërlidhur edhe me gjendjen psikike të një personi kemi një ndërlidhje mes sistemesh por dallim në terminologji. Vlen të përmendim edhe llojet e gjykatave të Mbretërisë së Bashkuar, edhe atë: gjykata e magistratëve(Magistrates Court) dhe gjykata e Kurorës(Crown Courts) si gjykata të shkallës së parë nga ku fillon e gjithë procedura dhe në shkallë të dytë kemi gjykatën e Apelit(Courts of Appeals), gjykata e lartë(High Courts) dhe në raste të caktuar edhe gjykatësit e kurorës ose ndyshe si njihet edhe si Gjykata Qendrore e Kurorës(Central Criminal Court) e cila është e vendosur në Londër e cila sgerben për krime më të mëdhaja që ndodhin në qytetin e Londrës dhe është e vendosur te e ashtuquajtura **Old Bailey** e cila bazohet në **The Baili Act**(Ligji për garancion,garanci,dorzani-masat e drejtuara ndaj personave në RM dhe bëhet nga ana e gjyqit) kurse në Angli jepet ose nga policia ose nga gjykata.⁸⁵ Shkurt vlen të përmenden edhe procedura e ankesës edhe pse nuk është temë ankesa por mendoj se është e rëndësishme pasi që siç e ceka kemi një sistem shumë të komplikuar të drejtësisë dhe mund të them se gjykata e Magistratëve si gjykatë e shkallës së parë vendos pothuajse për të gjitha rastet penale dhe kundër vendimeve të kësaj gjykate ankesë mund të bëhet deri te trup gjykues i mbretëreshëm së gjykatës së divizionit e cila është ankesë e rregullt që mund ta bëjë çdo palë edhe prokoria

⁸⁵ Gordana Lazhetiq Buzharovska,"Компаративно казнено процесно право",Shkup 2011 ,f.67,68

edhe mbrojtja kurse kemi edhe ankesë deri te gjykata e kurorës ankesë të cilën mund ta bëjë vetëm i pandehuri dhe e cila është e drejtë ekskluzive vetëm e të atij.⁸⁶

Si zakonisht, të gjitha procedurat penale fillojnë në gjykatën e Magjistratëve se 97 % e rasteve penale zgjidhen në këtë gjykatë, maximumi i dënimit është 6 muaj dënim nëse bëhet fjalë për një vepër kurse 12 muaj nëse bëhet fjalë për dy vepra dhe maximumi i dënimit me gjobë është 5.000 funta(pounds) ndërsa më pas vazhdojnë në gjykatën e kurorës mvarsisht nga rëndësia e veprës dhe lartësia e dënimit.⁸⁷ Më parë fola për llojet e gjykatave dhe i përmenda të gjitha llojet mirëpo përkundër ndarjes së gjykatave, në Mbretëriinë e Bashkuar kemi Shtëpinë e Llordëve si organ gjyqsorë më i lartë në shtet dhe e cila është e vendosur në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar. Arsyeja pse është i vendosur në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar është se i njeiti emërohet nga Kryemnistri i shtetit të Anglisë dhe kuptohet se shkarkohet vetëm nga ai dhe i njeiti ndrohet me ndrimin e Qeverisë. Ai është antarë i Parlamentit, antarë i kabinetit të Qeverisë dhe ka një rol shumë të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë sa i ërket emrimeve. Nuk duhet haruar të përmendi edhe faktin se i njeiti është Ministër Drejtësie.⁸⁸ Citoj si më lartë se të gjitha procedurat penale fillojnë të shqyrtohen në gjykatën e Magjistratëve dhe mvarsisht nga rëndësia e veprës dhe lartësia e dënimit pasi do dëdgojen nga e njehta gjykatë do shkojnë në gjykatën e Kurorës dhe e njehta do vendos. Gjykatat e Magjistratëve kryesisht vendosin për raste kur bëhet fjalë për një krim apo më mirë thënë një vepër të lehtë të dënueshme deri në 6 muaj nëse bëhet fjalë për një vepër apo deri në 12 muaj nëse bëhet fjalë për dy vepra për të cilën e sqarova edhe më lartë. Duhet ditur se në sistemin e Mbretërisë së Bashkuar minimimi dhe maximumi i dënimit fillon nga 5 ditë deri në burgim të përjetshëm. Mënyra se si shqiptohet një dënim është e përcaktuar nga **Këshilli për Përcaktimin e Dënimeve**. Këta në vete ngërthejnë apo paraqesin udhëzime të cilat udhëzime janë zhvilluar apo përforcuar edhe nga ana e **Asociacionit të Magjistratve** cila gjithashtu në vetë përfshinte udhëzime dhe të njejtat udhëzime i dërgon në gjykatën e Apelit të të cilët kontribuan në zhvillimin e aspektit të dënimeve. Ky këshill për përcaktimin e dënimeve u themelua nga **Akti i Drejtësisë dhe i Mjekëve Ligjor**(Coroners) në vitin 2009 dhe e cila është një trup e panvarur ku si qëllim kryesor ka analizimin dhe forcimin e besimit të publikut apo më qartë qytetarëve të vendit sa i përket shqiptimit të dënimeve nga ana e gjykatës. Në rast se bëhet

⁸⁶ Jacqueline Martin,"English Legal System",Oxon 2014, f.131

⁸⁷<https://www.thestar.co.uk/news/judge-s-praise-for-impeccable-south-yorkshire-police-after-five-killings-in-two-weeks-placed-intolerable-demands-on-force-1-9495931>

⁸⁸ Jacqueline Martin,"English Legal System",Oxon 2014,f.159,160

fjalë për vepra të lehta dhe duke e ditur se gjykata ka mundësi të shumta sa i përket zgjedhjes së dënimit, ku në rast konkret për vepra të lehta bëhet fjalë për dënime alternative rendi zbritës i ashpërsisë dhe nga ku mund të përmendim dhe mund të them se në Mbretërinë e Bashkuar kemi 4 lloje të dënimeve alternative dhe disa nënloje të këtyre dënimeve alternative, edhe atë: dënime të kujdesit, puna në interes të përgjithshëm, dënimi me gjobë dhe suspendimi i dënimit. Te dënimet e kujdesit kemi disa nënloje të këtij dënimi: dënim i përjetshëm i detyruar dhe dënimi diskrecional, dënim në afat të caktuar, dënim me ndërprerje dhe suspendim i dënimit, te puna në dobi të përgjithshme kemi disa nënloje tjera të këtij dënimi, ku përfshinë: puna pa pagesë, aktiviteti i ndaluar, kërkesat gjatë mbylljes në shtëpi, kërkesa për përjashtim apo dëbim (ndalimi të shkosh në vende të caktuara) dhe mbikëqyrja, e treta me rradhëeshtë dënimi me gjobë dhe suspendimi i cili mund të jetë i kushtëzuar dhe absolut si dënim i fundit alternativ.⁸⁹ **Dënimet e kujdesit** - ky dënim mund të shqiptohet vetëm në rastet kur mendohet se është e nevojshme të shqiptohet duke mos haruar që të meret parasysh edhe se me anë të këtij dënimi a do arrihet qëlimi i dënimit për personin e caktuar dmth shqiptohet në rastet kur bëhet fjalë për një krim apo vepër më të lehtë sa i përket pasojave. Nuk duhet haruar se për personat nga 18-20 vjet dënimi do e vuajnë në institucione për të rijtë kurse ata nga 21 e larte në burgun për të ritur. Është e rëndësishme të përmendet kjo nga shkakut se siç e cekim se edhe pse bëhet fjalë për dënim alternativ, në vete përfshin edhe dënim me burgim për personat që kryejnë krime më serioze. Dënimi diskrecional si nënloj i dënimit të kujdesit shqiptohet nga gjykata vetëm kur bëhet fjalë për krime serioze, kurse sa i përket nënlojit tjetër-dënimit të përjetshëm të detyruar e cila nënkupton burg të përjetshëm këtu bëhet fjalë për një vepër e cila është e rëndë dhe pasojat e së cilës dënohen me këtë lloj dënimi, kjo nënkupton se personi tërë jetën duhet ta kalojë në burg. Kjo kryesisht shqiptohet ndaj personave deri në 18 vjet ose mbi 18 vjet. Koha minimale që personi duhet të kalojë është e përcaktuar me anë të dispozitave të përcaktuara në **Aktin e Drejtësisë Kriminale 2003** dhe duke u bazuar në këtë akt gjykata mund të bëjë zvoglim të dëimit nga burgim i përjetshëm deri në 12 vite. Kjo ndodh kur kemi vrasje të dy ose më shumë personave për vepra të kryera nga sadizmi apo për vrasje me qëllime politike apo religjioze. Gatë zbatimit të kohës minimale të burgimit, nga ana e gjykatës merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Këtu bën pjesë edhe burgimi shtëpiak me mbikëqyrje si nënloj i dënimeve të kujdesit dhe i njëjti shqiptohet në rastet kur personi i dënuar lirohet para kohe nga shkakut se bëhet fjalë kryesisht për

⁸⁹ Jacqueline Martin, "English Legal System", Oxon 2014, f.140,141

vepër të lehtë dhe detyrohet që dënimin ta vuaj nën mbikëqyrje shtqpiake dhe e cila mbikëqyrje zbatohet në mënyrë elektronike dhe shumë e rëndësishme këtu është edhe lartësia e dënimit, dmth kemi të bëjmë me vepër kryesisht të lehtë dhe pasojate së cilës janë të evitushme. Si zakonisht burgu shtëpiak jepet për pesona të sëmurë dhe mendohet se burgu shtëpiak e cila thash së bëhet në mënyrë elektronike do ndikojë pozitivisht te recidivizmidhe për dallim nga RM-ja ku e kemi tëpërcaktuar në mënyrë shumë të qartë por kemi edhe ligj për probacion nga ku ky lloj dënimi duhet të zbatohet ku e dhash edhe shembullin me ish kryeministrin Nikolla Gruevski ku kam thënë se sikur të kishtë një sistem të tillë efikas elektronik për mbikëqyrje të burgut shtëpiak, ndoshta dhe nuk do ikte, është një pyetje që vlen të shtrohet si dilemë në këtë rast. Kemi edhe dënim të zgjatur në rast se vepra kryhet nga persona 21 vjet e lart dhe personat më të ri se 18 vjet kur bëhet fjalë për vepra të abuzimit seksual dhe në rast se bëhet fjalë për dëm publik. Një lloj tjetër është edhe dënimi i suspenduar(**probatio**). Vlen për veprat që dënohen deri në dy (2) vite. Për të njëjtn ka edhe mbikëqyrje. Gjatë kohës së mbkëqyrjes nëse nuk kryhet vepër penale do pritet deri sa të mbarojë dënimi dhe mbikëqyrja mirëpo nëse kryhet vepër tjetër penale gjatë kohës së mbikëqyrjes, kemi revokim të dënimit me kusht apo dënimit të suspendimit siç është e përcaktuar në terminologjinë angleze dhe e njejta zëvendsohet me burg dhe gjithashtu kemi edhe dënim për veprën tjetër të kryer. Kur shqiptohet ky lloj dënimi, merret parasysh preventiva speciale dhe gjenerale me qëllim që të ndikojë edhe tek personi ndaj të cilit shqiptohet ky dënim por edhe tek të tjerët dhe duke marrë për bazë këta rrethana shqiptohet ky lloj dënimi-suspendimi apo sipas teminologjisë sonë **probatio** apo dënim me kusht. Karakteristikat e këtij dënimi: koha e burgimit apo më mirë thënë shqiptohet për dënimet për të cilat është paraprë dënim nga 14 ditë deri në 6 muaj(24 muaj në gjykatën e Kurorës) për dallim nga ne ku dënimi me kusht shqitohet për vepra për të cilat është paraparë dënim me burgim deri dy vite, mbikëqyrja bëhet nga 6 muaj deri në dy vite për dallim nga RM-ja kur periudha e mbikqyrjes është nga një deri në pesë vite, duhet të realizojë kërkesa të caktuara, bashk me dënimin e suspendimit mund të shqiptohet edhe dënimi me gjobë për të cilën lirisht mund të them se është përafërsisht e ngjajshme me sistemit tonë të dënimeve alternative.⁹⁰ **Puna në dobi të përgjithshme**-vlen për personat nga 16 vjet e lartë. E rëndësishme është edhe lartësia e dënimit ku si zakonisht kjo shqiptohet për veprat e dënueshme deri në tre vite dhe që të mos i shqiptohetdënim me burgim, i shqiptohet puna në dobi të përgjithshme e cila në vete përfshin edhe kërkesa apo kushte që duhet plotsuar si psh:

⁹⁰<https://www.gov.uk/types-of-prison-sentence/suspended-prison-sentences>

rehabilitimi i narkomanëve apo trajtimi i alkoolistve për dallim nga ne ku trajtimi i alkoolostve dhe narkomanëve është lloj apo soj i masave(dënimeve) siguruese. Si nënloje të këtij dënimi mund të përnendim edhe atë: puna pa pagesë, aktivitetet që janë të ndaluara gjatë kësaj periudhe, ora e mbylljes brenda apo burgu shtëpiak edhe pse më lartë e përmenda dhe fola për burgun shtëpiak e njehta është identike vetëm sse e shprehur në një mënyrë dhe formë tjetër, exclusion requirement-ndalimi për të shkuar në vende të caktuara, dhe mbikëqyrja e cila gjithashtu është shumë e përafërt me nënlojin e dënimit të kujdesit(suspendimi) për të cilën fola më lartë. Si kjo por edhe të gjitha dënimet alternative bëhen me pëlqim të palës ku edhe në këtë rast kemi procedurë të ngjajshme me atë të RM-së. Sa i përket nënlojit të parë-puna pa pagesë mund të themi se është punë në të cilën punohet gjatë vikendeve, punë e cila përcaktohet nga ana e gjykatës e cila duhet të përfshij 8 orë gjatë vikendeve. Numri i orëve këtu është nga 40 orë deri 300 të cilat përcaktohet nga gjykata në bashkpunim me shërbimin e probacionit.⁹¹Si shembull në këtë rast mund të përmendi futbollistin e njohur Carlos Tevez cili në të njejtën kohë bën dy shkelje gjatë vozitjes. E para shkelje është se ka qenë pa leje dhe si shkelje e dytë se nuk ka pasur sigurim dhe për të njejtën ai është dërguar në gjykatë për zhvillim të procedurës ndaj tij ku edhe këta y shkeljet gjykata i ka marrë si rrethana rënduese dhe për të njejtën i është shqiptuar dënimi puna në dobi të përgjithshme-punë pa pagesë prej 250 orësh panvarsisht se i njejtë ka qenë fyre publike i njohur nga të gjithë duke marrë parasyh edhe faktin se i ka pasur edhe trajtimet me skuadrën i cili është dashur ti bëjë në mënyrë intenzive dhe ka qenë gati e pamundur për realizim të këtij dënimi. Gjatë zhvillimit të procedurës, ai e ka pranuar fajin, është dënuar me gjobë prej 1.145 funta angleze edhe pse ka pasur një rrogë të majme javore 196.000 funta por prap është dënuar me një dënim shumë të vogël në krahasim me shumën që përfitonte që edhe njëherit tregon për funksionin, respektimin e ligjeve por edhe për egzistimin e drejtësisë si drejtësi e barabart për të gjithë dhe se të gjithë janë të barabart para ligjit. Arsytimi i mbrojtësit(solicitor) të Tevez ka qenë se i njejtë parapraksisht ka pasur 6 muaj ndalesë për vozitje në momentin kur është ndalur nga policia pasi leja i është marrë për tejkalim shpejtësie dhe arsyetimi i dytë është se shumë persona në të kaluarën i kanë regjistruar veturat në emër të tij dhe të njejtë nuk kanë pasur asnjë ndëshkim. Të njejtën e vërteton edhe prokuroria se i njejtë nuk ka pasur leje për vozitje në momentin kur është ndalur nga policia dhe nuk ka pasur sigurim që paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion dhe ajo më e rëndësishmja këtu është se policia të njejtin edhe e ka arresuar dhe më pas

⁹¹ Jacqueline Martin, "English Legal System", Oxon 2014, f.141,142

e ka paralajmruar se vozit pa leje dhe nuk ka sigurim. Pra kjo tregon qasjen seriozite të drejtësisë ndaj shkelësve panvarsisht se për cilin bëhet fjalë, për qytetar të rëbdomtë apo për futbollist apo kushdo qoft. Nuk duhet lënë pa përmendë edhe faktin se Carlos Tevez paraprakisht ka pasur komunikim me zyrtarin e probacionit dhe kjo tregon qasje serioze dhe zbatimimi i dispozitave të ligjit për gjithçka. I tërë procesi u zhvilluar në gjykatën e Magjistratëve.⁹² Mirëpo edhe përkundrahe asaj se u zhvillua procedura, iu shqiptua dënimi, i njëjti nuk u dënua dhe po të kthehemi pas në vitin 2013 kur Carlos Tevez i bëri shkeljet në fjalë dhe për të cilat i u shqiptua dënimi i paraparë, në po atë vit (në vitin 2013) bëri transferim në Juventus dhe paguajti dënim në vend të punës pa pagesë edhe pse ai përsëri duheshte që ta përmbush dënimin për shkeljet e bëra por transferimi te **Juventus** ia mundësoj që i njëjti të zëvendsohet veç me pagesë të gjobës dhe gjithashtu edhe klubi për të cilën luante para transferimit **Manchester City** ishte deklaruar dhe argumentuar se ai nuk kishte më përgjegjësi për ligjet e Anglisë dhe ishte e pamundur ta vuaj dënimin. Gjykatësi i procedurës e pranoi këtë duk marrë parasysh rrethanat dhe pamundësinë për vuajtje të dënimit dhe icitoj fjalët e të njetit: **"kjo është vetëm prishje teknike. Nuk është e përsëris nuk është, rast kur një futbollist e njëlloj hundën e vet të rendi i gjykatës."**⁹³ Si nënloj tjetër i punës në dobi të përgjithshme është edhe aktiviteti që personi e ka të ndauar ta bëjë pra të mos shkojë në vende të caktuara apo të mos veshë veshje të caktuara pra gjëra që e largojnë nga kryerja e sërishme e veprës penale, si nënloj tjetër është edhe koha e mbylljes brenda dhe paraqitet si burg shtëpiak. Monitorohet në mënyrë elektronike. Duhet qëndruar në adresën që e posedon apo në shtëpi nga 2-12 orë prej gjithsej 24 orëve. E njëjta zgjat 6 muaj. Kostoja e mbikqyrjes është 675 funta në muaj në krahasim me burgun e cila përfshin një kosto prej 1.555 funta në muaj, nënloj tjetër është edhe kërkesa për dëbm apo ndalim (exclusion requirement)-paraqet ndalim për shkuarje në vende të caktuara me qëllim të mos kryerjes së sërishme të ndonjë veprë penale. Zgjatën dy vite për personat nga 16 vjet e lartë dhe tre muaj për ata nën 16 vjet, mbikqyrja si nënloj tjetër bëhet nga zyrtarë të probacionit në afat prej tre vitesh. I dënuari është i detyruar të jap raport zyrtarit të probacionit.⁹⁴ **Dënimi me gjobë**-është dënim ëq kryesisht zbatohet në gjykatën e Magjistratëve. Kemii 5 shkallë apo 5 lloje të dënimit: I-200 funta, II-500 funta, III-1000 funta, IV-2500 funta, V-5000 funta. Për personat nga 10 deri 13 vjet maximumi i dënimit është 250 funta kurse për personat nga 14 deri 17 vjet është 1.000 funta. Në rast se bëhet fjalë për

⁹²<https://www.theguardian.com/football/2013/apr/03/carlos-tevez-admits-driving-disqualified>

⁹³<https://www.theguardian.com/football/2013/jul/10/carlos-tevez-community-service-order>

⁹⁴ Jacqueline Martin, "English Legal System", Oxon 2014, f.141,142

siguri në vend të punës gjykata e Magjistratëve mund të shqiptohë edhe dënim deri në 20.000 funta, kurse gjykata e Kurorës mund të shqiptojë dënime të pa kufizuara me gjobë. Para shqiptimit të këtij dënim, gjykata do marr të dhëna për personin nëfjalë (procedurë e ngjajshme me at të MK-së), si dhe dënimi i fundit është **discharge(lëshim)**-e cila mund të jetë: e kushtëzuar dhe absolute. Lëshimi i kushtëzuar nënkupton lëshim me kusht e cila ka periudhë të mbikëqyrjes e cila mund të zgjas 3 vite dhe nënkupton se brenda këtyre 3 viteve nuk duhet kryer vepër e re. Kjo bëhet kur ndëshkimi nuk është i nevojshëm, mirëpo i njëjti do dënohet nëse gjatë periudhës së kontrollit kryen vepër tjetër, kurse lëshimi absolut nënkupton s nuk duhet plotsuar ansnjë kusht, personi lirohet menjëherë nga shaku se ka pendim. Pendimi merret si rrethanë lehtësuese në këtë rast.⁹⁵ Vlen të përmendet edhe e ashtuquajtura **pëlqim i Madhësisë së Saj(her Majesty's pleasure)** e cila paraqet një dënim të pa përcaktuar e cila është e paraparë te veprat që i kryejnë personat nën 18 vjet respektivisht nga 10 deri 17 vjet kur vlersohet se kjo është e përshtatshme dhe e njeta është pjesë e dënimeve të kujdesit që parashihshte dënim i përjetshëm për personat që bëjnë vepra të natyrës politike dhe religjioze. Gjykatësi në këtë rast mund të japë minimumin e viteve që personi duhet ti kalojë na burg.⁹⁶ Të gjitha dënimet alternative që mund të them se shqiptohen kryesist për veprat që dënohen max deri në 3 vjet zhvillohen në gjykatën e Magjistratëve pasi thash në fillim se 97% e rasteve penale zhvillohen në këtë gjykatë duke ditur edhe se kompetenca e kësaj gjykate është për vepra deri në 12 muaj. Nuk ka juri (trup gjykues) por çështja gjykohet nga gjyqtari individual. Duhet theksuar se procedura është publike. Edhe rastet më të rënda dëgjohen këtu e më pas dërgohen në gjykatën e Kurorës. Gjykata e Kurorës vendos edhe për ankesat e gjykatës së Magjistratëve. Vendos për rastet e rënda që kalojnë nga gjykata e Magjistratëve. Ka trup gjykues të udhëhequra nga një gjykatës caaktuar. Seancat janë publike. Kemi gjykatën e Londërs që është gjykata qendrore kriminale për të cilën fola edhe në tekstin më lartë, është e vendosur në Old Bailey dhe e cila bazohet në Bailey Act (Ligji për garancion, dorzania që bëhet nga ana e policisë dhe gjykatës).⁹⁷ Sanksionet penale më të zbatueshme janë: burgimi në afat të caktuar, burgimi i përjetshëm, kompensimi i dëmit, marrja e lejes, masa për mejnanimin e pasojave dhe pushimit të pasojave. Sanksionet penale shqiptohen me

⁹⁵ Jacqueline Martin, "English Legal System", Oxon 2014, f.142

⁹⁶ Jacqueline Martin, "English Legal System", Oxon 2014, f.140

⁹⁷ <https://www.thestar.co.uk/news/judge-s-praise-for-impeccable-south-yorkshire-police-after-five-killings-in-two-weeks-placed-intolerable-demands-on-force-1-9495931>

qëllim që personi të ndëshkohet për veprën e kryer pra karakteri represiv e jo hakmarje.⁹⁸ Gjatë matjes së dënimit në nga gjykatësit e Mbretërisë së Bashkuar, rrethanat që merren parasysh janë si psh: preventiva speciale dhe gjenerale dmth se ky dënim a do ndikojë që personi të mos kryejë përsëri vepër penale dhe e njëjta a do ndikojë edhe te të tjerët, mbrojtja e shoqërisë-a do ndikojë dënimi qoft alternative ose sanksioni penal që personi të mos bëjë apo të mos përsëris vepra që e dëmtojnë rrethin e atij apo shoqërinë në përgjithsi, rehabilitimi. Vlen të përmendet edhe mosha, serioziteti i krimit, a është primar apo recidiv personi, rrethanat rrënduese, lehtësuese, paramendimi, armiqsia religjioe apo seksuale paraaqesin rrethana që një gjykatës anglez i mer për bazë gjatë matjes së dënimit për shqiptimin e dënimit. Si rrethanë rrënduese merret recidivizmi kurse si rrethanë lehtësuese merret ajo nëse personi ka probleme në jetën private dhe se ajo ndikon në kryerjen apo ajo e shtynë që të kryejë vepër penale. Dhe në fund kuptohet që gjykata çfardo vendimi që të mer duhet ta arsyetojë atë, ta thot në mënyrë të hapur, shpenzimet e procedurë. Ajo që mund të them është se e gjithë procedura nga i tërë ky sistem i komplikuar i dënimeve që e ka Mbretëria e Bashkuar, lart e posht ngjason me sistemin e RM-së apo thënë më mirë RM-ja i ngjason shumë sa i përket këtij aspekti dhe mund të them se është një përshtatje e përkryer nga ana jonë mirëpo praktika flet ndryshe.⁹⁹

3.2. A duhet bërë reduktimi i dënimeve alternative në RM dhe pse (duke marrë parasysh dënimet alternative momentale ku nga gjithsej 6 zabtohen vetëm dy respektivisht vetëm një-dënim me kusht dhe vërejtja gjyqsore)?

Duke marrë për bazë debatet e shumta që po zhvillohen për ndryshimin e Kodit Penal pasi që në vete përfshin shumë gjëra të cilat janë të pa përshtatshme, ngërthen në vete shumë padrejtisi dhe për në dis sfera të caktuara nuk është caktuar dënim adekuat apo për sfera të caktuara nuk është caktuar aspak dënim.

Po të nisemi nga dy debatet e fundit, ajo e 2010 dhe ajo e 2015 mund të vërejmë p.sh në debatin e 2010 profesori univerzitar Nikola Tupancevki në debatin "Kodi Penal i noveluar (i ndryshuar apo i ri)" thekson se egzistojnë shumë zbrastira në Kodin Penal ku theks të veçantë i kushtoi krimit të organizuar dhe se me anë të këtij kodi nuk është arritur qoft edhe deri të një zgjidhje

⁹⁸ Gordana Lazhetiq Buzharevska, "Компаративно канено процесно право", Shkup 2011, f.85

⁹⁹ Jacqueline Martin, "English Legal System", Oxon 2014, f.143,144,

minimale sa i përket krimit të organizuar dhe gjithashtu sa i përket përgjegjesisë për personat juridik duke cekur se problemi i tillë me personat juridik do vazhdojë si rezultat i traditës që kjo nënkupton se në traditën maqedonase nuk egziston një traditë e këtillë sa i përket rregullimit të përgjegjesisë së personave juridik dhe nga ana tjetër edhe një mori problemesh sa i përket vjedhjeve të rrënda, për veprat që kanë të bëjnë me drogën, për vepra të mashtrimeve doganore dhe gjithashtu theksohet se sa i përket komunikimeve Ministria e Punëve të Brendshme është tepër e privilegjuar sepse ka qasje 24 h deri tek informacionet, kurse nga ana tjetër kemi debatin e 2015 bauer në pjesën sa i përket veprave të gjuhës së urrejtjes (hate speech) ku theksohet se në Kodin Penal vetëm një nen flet për gjuhën e urrejtjes (neni 319) në pjesën e veprave kundër shtetit-pjesa e posaçme.¹⁰⁰ Nga gjithë këta debate që u zhvilluan por edhe shumë debate tjera të cilat nuk i përmenda por që kryesisht flitet për këta çështje në asnjë deri tash por kryesisht në këta dy debate të cilat i përmenda më sipër nuk diskutohet aspak për masat alternative, mënyra e funksionimit, sa nga dënimet alternative nga gjithsej 6 zbatohen në praktikë, nëse nuk zbatohen të gjitha pse nuk zbatohen dhe çfarë masash duhet të ndërmeren e shumë e shumë pyetje të këtij lloji, mirëpo deri tash nuk kemi debat të këtillë, as që interesohet kush për dënime alternative shkurt thënë janë përcaktuar në Kodin Penal dhe e gjithë pas asaj është lënë vetë në duar të gjykatësve edhe pse të njëjtit nuk interesohen fare për atë apo vetëm një numër i vogël sa i përket mbipopulmit të burgjeve dhe ndoshta për atë arsye do i shqiptojnë dënimet alternative pasi realisht në praktikë vetëm dënimi me kusht dhe në raste të rralla vërejtja gjyqësore shqiptohet por gjithashtu nuk funksionon edhe ligji për probacionin i cili gjithashtu por edhe shërbimi i provës. Po të bëjmë një krahasim me Mbretërinë e Bashkuar nga ku dhe mund të them se është djepi i dënimeve alternative, në Mbretërinë e Bashkuar egzistojnë 4 lloje të dënimeve alternative dhe të njëjtat zbatohen dhe është dhe shembulli që e dhashë gjatë krahasimit të RM-së me Anglinë me lojtarin e Manchester Cityt Carlos Tevez i cili edhe pse nuk u dënua shkak i transferit në Juventus që e bëri në atë periudhë, ndaj të njëjtit u zhvillua procedura normale sikur që zhvillohet ndaj çdo qytetari edhe pse i njëjti ishte person publik dhe mos haroj pa e përmendur se i njëjti edhe u arrestua dhe i cili më pas kishte komunikim edhe me zyrtarin e probacionit gjë që tregon edhe njëherë se ligji funksionon njëjtë ndaj çdo qytetari dhe se këtu vlen parimi barazi e të gjithëve para ligjit dhe që në rast konkret kemi të bëjmë me zbatimin e


¹⁰⁰<https://www.akademik.mk/javna-rasprava-po-predlog-amandmanite-na-kz-i-drugite-zakoni-koi-se-odnesuvaat-na-krivichnite-dela-od-omraza/>

dënimit për veprën e kryer, pra sikur të kishim më pak dënime alternative ndoshta do kishim më shumë sukses p.sh(modeli i Anglisë me katër dënime alternative:dënimi me kusht, puna në dobi të përgjithshme, burgu shtëpiak dhe vërejtja gjyqsore)duke marrë parasysh edhe funksionimin në rregull të procesit të monitorimit, mbikqyrjes funksionimin e ligjit për probacion dhe zyrtarve të probacionit si shembul siç e përmenda edhe gjatë punimit tim psh nëse një stomatolog kryen një vepër të lehtë penale ti shqiptohet dënimi puna në dobi të përgjithshme(puna pa pagesë) dhe të bëjë kontrollimin e dhëmbëve të fëmijëve nëpër shkolla fillore ose të mesme pa pagesë apo p.sh nëse me ligj është e pëcaktuar se nëse studenti vjedh në provim kjo të parashihet si vepër penale e dënueshme deri në 1 vjet nga shkaku se ai në të ardhmen mund të jetë rrezik për shoqërinë dhe nëse bëhet për herë të parë të shqiptohet vërejtje gjyqsore që të jetë një paralajmërim për atë që të njejtën të mos e përsëris dhe e njehta të jetë preventivë speciale dhe gjenerale, ose sa i përket burgut shtëpiak p.sh nëse një person kryesisht i ri kryen një vepër penale, vepra për të cilën bëhet fjalë është e dënueshme 3 vjet dhe ndaj të njejtit zhvillohet procedurë dhe shqiptohet burgimi mirëpo në ndërkohë mësohet si i njejt ka kancer në këtë rast duhet bërë zbutja e dënimit dhe dënimi me burgim të zëvendsohet me burg shtëpiak duke e ditur seky lloj dënimi shqiptohet nëse bëhet fjalë për persona që kanë ndonjë sëmundje të rëndë kurse dënimi me kusht është veçse një dënim i cili zbatohet thaujse çdo dit nga gjykatat e RM-së dhe është një ndër dënimet më të shprehura dhe duke u bazuar nga rezultatet e praktikës e cila tregon se si dënimi me kusht, si vërejtja gjyqsore dhe kohës fundit edhe burgu shtëpiak janë dënime që zbatohen në praktikën e gjykatave të RM-së me përjashtim puna në dobi të përgjithshme nga 2004 deri sot është zbatuar vetëm një herë kjo edhe si rezultat i mos funksionimit të ligjit mbi probacion kurse dy dënimet tjera alternative(dënimi me kusht me mbikqyrje të shtuar dhe ndërprerja me kusht e procedurës penale) që nga viti 2004 deri më sot asnjëherë nuk është zbatuar gjë që tregon se janë pjesë e sistemit të dënimeve në letër por edhe nuk janë të realizueshme në praktikë.

KAPITULI IV


Hulumtimi dhe rezultatet

4.1. Analiza e të dhënave statistikore




Grafiku 1- aktet me të cilat është inicuar procedura penale

në Gjykatën Themelore-Gostivar




Grafiku 2- të dhena statistikore nga vendimet e sjellura nga Gjykata

Themelore-Gostivar(të plotfuqishme,të ekzekutueshme)



Grafiku 3- aktet me të cilat është inicuar procedura penale në Gjykatën Themelore-Tetovë



Grafiku 4- të dhena statistikore nga vendimet e sjellura nga Gjykata Themelore-Tetovë(të plotfuqishme,të ekzekutueshme)

4.2. Analizë e intervistës

Intervistë

Për temë masteri "Matja gjyqsore e sanksioneve penale dhe zbatimi i dënimeve alternative në R.M"

1. A i besojnë qytetarët pushtetit gjyqsorë respektivisht parimit të pavarësisë së gjykatave?

PO 7

JO 20

2. Sa gjykata luan rol në zbatimin e drejtësisë, dënimin e kryerësve dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve?

Pak 16

Shum 11

Tepër /

3. Sa është efektive shqiptimi i dënimeve alternative nga ana e gjykatës ndaj kryerësve të veprave penale?

Pak 13

Shumë 13+1 pa përgjigje

Tepër /

4. A kemi kushte për shqiptimin e dënimeve alternative?

PO 20

JO 7

5. Dënimi me kusht si dënim më i shqiptuar nga dënimet alternative, a do ndikonte në reduktimin e po të njëjtave (dënimeve alternative)? (Sqarim)

PO 17

JO 10

6. Nëse dënimet alternative ndryshohen dhe reduktohen si në vitin 2004 kur egzistonin dy dënime alternative (dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqsore), a do ishte kjo zgjidhja më e mirë? Nëse po pse? (Sqarim)

PO 8

JO 19

7. A do kishte ikur Nikolla Gruevski sikur të funksiononte sistemi i hallkave elektrike (për funksionim të burgut shtëpiak), sistem i mundur për funksionim me ligjin për probacion? (Sqarim)

PO 7
JO 18+2 pa përgjigje

8. Si i komentoni rastet e fundit të shqiptimit të burgut shtëpiak (Mijalkov, Kamçev e të tjerë)? (Sqarim)

9. Ligji për rregullimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit (Закон за одредување на видот и одмерување на висината на казната), a ishte diskriminues dhe a mendoni se shfuqizimi i të njejtit është zgjidhja më e mirë? (Sqarim)

PO 7
JO 19+1 pa përgjigje

10. Me matjen e dënimit sipas bindjes së gjyqtarit, a vihet drejtësia në vend? (Sqarim)

PO 11
JO 16

Ghithsej-27(14 shqiptarë dhe 13 maqedon)

4.3. Analiza e pyetsorit

Pyetsor

Për temë masteri "Matja gjyqsore e sanksioneve penale dhe zbatimi i dënimeve alternative në R.M"

1. Akeni njohuri për dënimet alternative në Republikën e Maqedonisë?

PO 25(64.1%)	ДА 3(37.5%)
JO 14(35.9%)	НЕ 5(62.5%)

2. Nëse po, të njejtat a janë efektive?

PO 13(35.1%)	ДА /
JO 24(64.9%)	НЕ 6(100%)

3. A duhet bërë reduktimi i dënimeve alternative?

PO 22(61.1%)	ДА 4(50%)
JO 14(38.9%)	НЕ 4(50%)

4. Apo duhet shtuar edhe më shumë lloje të dënimeve alternative?

PO 24(66.7%)	ДА 6(75%)
--------------	-----------

JO 12(33.3%) HE 2(25%)

5.A e dini se dënimi me kusht si lloj i dënimeve alternative është dënimi më i shqiptuar nga të gjitha 6 llojet e dënimeve alternative dhe të gjitha dënimet tjera kryesore dhe sekondare?(Sqarim)

PO 17(45.9%) DA 2(33.3%)

JO 20(54.1%) HE 4(66.7%)

6.A janë të pavarura gjykatat në vendin tonë në sjelljen e vendimeve?(Sqarim)

PO 10(27%) DA 2(28.6%)

JO 27(73%) HE 5(71.4%)

7.A luan rol pavarisja e gjykatave në zbatimin e drejtë të dënimeve alternative dhe dënimeve tjera si p.sh dënimi me burg?(Sqarim)

PO 27(71.1%) DA 2(33.3%)

JO 11(28.9%) HE 4(66.7%)

8.Një pushtet gjyqsorë i kapur nga pushteti,aluan rol në zbatimin edrejtësisë?(Sqarim)

PO 24(63.2%) DA 4(57.1%)

JO 14(36.8%) HE 3(42.9%)

9.Antarsimi në BE, a do ishte zgjidhje në këtë rast?

PO 7(19.4%) të tjera 26(72.2%) DA 1(12.5%)

JO 3(8.3%) HE 7(87.5%)

10.A duhet të zhvillohen debate të hapura(publike) duke përfshirë edhe student të fakulteteve juridike nga të gjitha univerzitetet në vend?(Sqarim)


PO 38(100%) DA 7(87.5%)

JO / HE 1(12.5%)

Gjithsej 47(39 shqip dhe 8 maqedonisht)


1. A keni njohuri për dënimet alternative në Republikën e Maqedonisë?

39 responses




10. A duhet të zhvillohen debate të hapura(publike) duke përfshirë edhe student të fakulteteve juridike nga të...end? Nëse po pse nëse jo pse? (Sqarim)

38 responses




3. Дали треба да се направи редукутирање на алтернативните мерки?

8 responses



4. Или треба да се додават уште вида алтернативни мерки?

8 responses



Përfundimi

Nëse bazohemi në atë që është e shkruar(formale) gjithçka është perfekte gjithçka është Europiane mirëpo nëse kthehemi në realitet është krejtësisht ndryshe. Gjithashtu edhe ligjet i kemi perfekt mirëpo vetëm në formë të shkruar kurse në praktikë zbatohen vetëm ata ligje që i konvenojnë individëve të caktuar pra jemi një shtet ku në këtë shtet ka shumë shtete pra është një sistem krejtësisht i kundërt me atë **Europian** pasi që e ceka më lartë se ligjet i kemi kryesisht europiane. Pikërisht kjo është edhe arsyeja se përse unë e zgodha pikërisht këtë temë si temë masteri me qëllim që të hulumtoj dhe të studjoj sa i përket dënimeve alternative, zanafillës së dënimeve alternative e shumë çështje të tjera në lidhje me dënimet alternative. Duke marrë parasysh edhe dy debatet e fundit që janë zhvilluar një në vitin 2010 dhe një në vitin 2015 ku si pjesmarës ka qenë edhe profesori i nderuar universitar Nikolla Tupançevski dhe ku është zhvilluar debat në lidhje me Kodin Penal dhe për mangësitë që i ka ky kod ku theks të veçanëtë iu kushtua krimit të organizuar dhe se me anë të këtij koddi nuk është arritur qoftë edhe deri te një zgjidhje minimale sa i përket krimit të organizuar dhe gjithashtu si zbrastirë tjetër përmendet edhe përgjegjsia e personave juriidik, për vepra sa i përket vjedhjeve, për veprat e drogës, ata të doganave, veprat që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes(hate speech) ku theksohet se në Kodin Penal vetëm një nen flet për gjuhën e urrejtjes(neni 319) i Kodit Penal. Jo rastësisht kam folur për të gjitha këta çështje respektivisht për debatet që janë zhvilluar në lidhje me të drejtën penale dhe jo rastësisht i ndërlidha me faktin se nga të gjitha këta debate të zhvilluara në asnjë debat nuk është folur për masat alternative, mënyrën e funksionimit të këtyre masave, a zbatohen të gjitha nëse nuk zbatohen të gjitha cila është arsyeja, aduhet të meren masa, çfarë masa duhet të ndërmeren. Duke marrë parasysh të gjithë këta rrethana dhe faktorë dhe duke shfrytëzuar burime të ndryshme unë arrita që të tregoj deri diku pse e kam marrë këtë temëbazuar edhe në hipotezat e shtruar duke përfshirë edhe IV kapituj këtu edhe atë;në kapitulin e I kryesisht bazuar në lëndën e hulumtimit ku si lëndë e hulumtimit të punimit të tezës së magistraturës me temë "Matja gjyqore e sanksioneve penale dhe zbatimi i masave alternative në Republikën e Maqedonisë" është kjo tezë paraqet një pasqyrë mbi atë se si është e rregulluar kjo sipas legjislacionit tonë dhe tregon për kushtet se si duhet shqiptuar, qëllimi i hulumtimit ku si qëllimi kryesor i hulumtimit është studimi dhe analiza sa i përket matjes gjyqore të sanksioneve penale dhe zbatimi i masave alternative ku theks të veçantë do të kushtohet asaj se si gjykatat e bëjnë matjen gjyqore të

sanksioneve penale dhe dënimeve alternative si pjesë e sanksioneve penale, sa masat alternative janë të zbatueshme në praktikë dhe ndryshimeve të bëra në vitin 2004 pasi që deri në vitin 2004 kishim dy lloje të dënimeve alternative (denimi me kusht dhe vërejtja gjyqsore) kurse pas viti 2004 u shtuan edhe katër, hipotezat ku për realizimin e këtij punimi jam bazuar në 5 hipoteza (roli i gjykatave në zbatimin e drejtësisë, efektiviteti i shqiptimit të dënimeve alternative, pavarësia e gjykatave gjatë shqiptimit të dënimeve, besueshmëria ndaj pushtetit gjyqsor dhe duke shtruar pyetjen se a kemi kushte për shqiptimin e të gjitha dënimeve alternative) të cilat jam munduar tu përmbahem deri në fund të punimit tim dhe për metodologjinë e hulumtimit me anë të shfytimit të analizave dhe sintezave si metoda gjerësisht të shfrytzuara për të arritur në përfundime të pranueshme dhe logjikisht të arsyeshme, në kapitullin e II kryesisht për aspektin juridiko-penal të dënimeve alternative në jurisdiksionin e brëndshëm dhe të jashtëm ku kryesisht jamë bazuar historikun e dënimeve alternative pra kur për herë të parë janë përdorur dënimet alternative nga ku edhe kam përmendur se për herë të parë janë përmendur në dënimin me kusht si pjesë përbërëse Kodit Penal të ish RSFJ-së më 1951, për evolucionin e dënimeve alternative me theks të veçantë për ndryshimet e bëra në vitin 2004 pasi që deri në vitin 2004 kemi pasur dy dënime alternative edhe atë: denimi me kusht dhe vërejtja gjyqsore kurse pas ndryshimeve të bëra në 2004-ën u shtuan edhe 4 llojë tjera të dënimeve alternative, për ligjin për matjen e dënimit-përparsitë dhe magësite e këtij ligji mirëpo si përparsi nuk u gjet për këtë ligj pasi mangësitë ishin të shumta ku si mangësi kryesorë ishte emërtimi pasi flet për të gjitha sanksionet, për matjen e dënimit sipas Kodit Penal aktual nga ku gjykatësi këtu merte parasysh rrethanat lehtësuese, rrënduese, jeta e mëparshme e kryerësit, sjellja pas kryerjes së vepërës penale, motivi etj, ligji për probacion jam munduara ta elaborojë si i atillë si është pasi që ligji i këtillë egziston por nuk zbatohet në praktik si dhe për llojet e dënimeve me theks të veçantë për dënimet alternative në Shqipëri, në kapitullin e III kam përfshi dënimet alternative të R.M-së në raport me dënimet alternative të Mbretërisë së Bashkuar-aspekti krahasues pra çfarë përparsi kanë dhe a do mundeshim ata përparsi ti fusim në sistemin tonë duke ditur nga hulumtimi i bërë se në Angli kishim 4 lloje të dënimeve alternative dhe shumë nënloje të dënimeve alternative dhe në kapitullin e IV sa i përket analizës dhe hulumtimit që kryesisht ka të bëjë me statistika, analiza të pyetsorit dhe intervista.

Rekomandime

- Të zhvillohen debate në këtë sferë, debate ta hapura ku përveç profesorve eminent do mund të marrin pjesë edhe student eminent(të zgjedhur) të juridikut nga të gjitha universitetet në vend.
- Ti marrim përparsitë e dënimeve e sidomos dënimeve alternative, sfera në të cilën kemi shumë mangësi e sidomos nga vende të zhvilluara europiane pse jo edhe nga vendet anglo saksone duke e ditur se edhe dënimet alternative respektivisht dënimi me kusht për herë të parë është zhvilluar në Mbretërinë e Bashkuar si vend anglo-sakson nga ku dhe ka pasur tri sisteme:anglo-sakson, euro kontinental dhe ai mix ose Zvicra shtet me sistem më të sofistikuar të dënimeve ku mund të përmendim edhe dënimet nga një ditë deri në 3 muaj apo nga 3 ditë deri në 3 vjet.
- Përforcimi i ligjit mbi probacionin, ligj shumë i rëndësishëm për funksionimin e dënimeve alternative(për 3 lloje) dhe forcimin e nënpunësve të probacionit.
- Panvarsimi i gjyqsorit për zbatim të panvarur të dënimeve e sidomos dënimeve alternative dhe matjen e drejtë dhe të panvarur të dënimit.

Bibliografia

Burimet kryesore, libra, ligje, referenca online

- Vllado Kambovski(2014) "E drejta penale" pjesa e përgjithsme,Shkup
- Ismail Zejneli, Ejup Sahti(2017) "E drejta e procedurë penale e Republikës sëMaqedonisë" botimi i dytë i ndryshuar dhe i plotsuar
- KP-Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,nr.199/2014
- pravdiko-<https://www.pravdiko.mk/>
- <http://pravo.org.mk>
- Vllado Kambovski(2015) "Komentar na krivicniot zakonik na Republika Makedonija, Shkup
- Sllagjana Taseva, Gordan Kalajxhiev, N.Gllavince(2012) "Pravosuden ispit", nacionalna i univerzitska biblioteka "SV.Kliment Ohridski", Shkup
- Gordana Lazetiq-Buzharova(2003) "Alternativi za zatvorot", Shkup

- Gordana Lazetiq-Buzharova, Gordan Kalajxhiev, B.Misoski(2011) "Komparativno kazneno procesno pravo", Shkup
- Afrim Osmani(2013) "Komentari i ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve", Shkup
- Bajram Ukaj(2006) "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë", Prishtinë
- Natasha Mrvic-Petrovic(2008) "Krivicno pravo", Beograd
- Vllado Kambovski, Nikolla Tupancevski(2015) "Kodifikimi i legjislacionit penal", Shkup
- Todor Vitlarov, J.Ilievski(2016) "Zbatimi praktik i marvshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri të procedurës penale-analizë juridike
- Jacqueline Martin(2014) "English legal system", Milton Park, Abingdon, Oxon OX14RN,Neë York, NY 10017
- Luan Omari, Aurela Anastasi(2017), "E drejta kushtetuese", Tiranë, SHTËPIA BOTU-ESE "Dajti 2000", vështime të përgjithsme, neni-116
- Dr.Zvonimir Separovic, "Alternative kazni zatvora", Sarajevë,1988(punim i prezantuar në mledhjen e katedrave penale të mbajtura në Sarajevë)
- Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mosarrestimit(Rregullat e Tokios)
- Никола Тупанчевски,Љубомир Шрговски(2010) Јавна расправа "Новелираниот Кривичен законик на Република Македонија"
- duke iu referuar të gjitha shënimeve të mara gjatë ligjeratave në të drejtën penale sa i përket matjes së dënimit dhe dënimeve alternative

Ligjet

- Ligji mbi procedurën penale i Republikës së Maqedonisë-LPP,Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.150/2010
- Ligji për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.199/2014
- Ligji për probacion, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.226/15
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.11/2016

Referencat online

- <http://journal.maclc.mk/wp-content/uploads/2017/05/Dzemali-Saiti.pdf>
- <http://journal.maclc.mk/wp-content/uploads/2017/05/Vitlarova-Tamara.pdf>
- <http://www.telegraph.co.uk/news/2019/01/22/cristiano-ronaldo-avoids-prison-accepts-19-million-fine-spain/>
- www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2014/02/Upatstva-za-odreduvane-na-vidot-i-odmeruvane-na-visinata-na-kaznata.pdf
- www.akademik.mk/wp-content/uploads/2016/09/Zlatko-Predavane-za-Akademik.pdf
- <https://www.alsat-m.tv/emisionet/emisioni-360-grade-14-01-2019/>
- <https://sdk.mk/index.php/makedonija/durlovski-vo-kuken-pritvor-za-pratenichkata-peshevska-poblagi-merki-na-pretpazlivost/>
- <https://sitel.com.mk/>
- <http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf>
- <https://www.thestar.co.uk/news/judge-s-praise-for-impeccable-south-yorkshire-police-after-five-killings-in-two-weeks-placed-intolerable-demands-on-force-1-9495931>
- <https://www.gov.uk/types-of-prison-sentence/suspended-prison-sentences>
- <https://www.theguardian.com/football/2013/apr/03/carlos-tevez-admits-driving-disqualified>
- <https://www.theguardian.com/football/2013/jul/10/carlos-tevez-community-service-order>
- <https://www.akademik.mk/javna-rasprava-po-predlog-amandmanite-na-kz-i-drugite-zakoni-koi-se-odnesuvaat-na-krivichnite-dela-od-omraza/>

Shtojca

Dënim i nda-luar	I.i pa dënuar	II.der i në dy akt gjykime për veprat penale për të cilat është parapa dënim me gjobë apo me burgim deri në 5 vite	III.der i në dy akt gjykime ku njëra është për ve-prër penale për të cilën është parapa dënim deri në 5 vite	IV.tre ose dy akt gjykime me shqiptiin e dënimit efektiv me burgim mbi 6 muaj ose një akt gjykim me shqipti-min e dënim-it efektiv me burg më së paku deri në 3 vite	V.4 ose 2 akt gjykime me ahqip-timin e dënimit me burg më së paku deri në dy vite ose 1 akt gjykim me shqiptm të dënimit me burg prej më së paku deri në 5 vite	VI.5 ose më shumë akt gjyki-me ose 2 akt gjyki-me me më së paku 5 vite burg ose 1 akt gjykim me së paku 8 vjet burg
I						
dënim me gjobë	30-60 gj.d	40-80 gj.d	80-100 gj.d	100-130 gj.d	130-160 gj.d	160-180 gj.d
XXII						
burgim nga 3 muaj deri në 5 vite	3-24 m 18 m	9-30m 20m	12-36m 24m	24-48m 36m	36-54m 45m	48-60m 54m
XLVII						
më së paku 10 vite burg apo burg i përjetshëm	120-144m 132m përjetshëm(177)	132-156m 144m	144-168m 156m	156-168 162m	160-180 o burg. i përjetshëm(174m)	174-180m o burg. i

Shablloni nr.1-Ligj për matjen e dënimit

	nr.d.alternative	d.me kusht	d.me gjobë	d.me k.me mbikqyrje	Ndër.me kusht e proced.pen	Puna në d.të të përgj.	Vër.gjyqso re	Burgu shtëpiak
2005	4456	4307					149	
2006	4849	4369	315					
2007	4936	4298	426			1	214	
2008	5059	4266	611				182	
2009	4878	4238	460				180	
2010	4283	3753	385				145	

**Tabela nr.1-statistikë sa i përket shqiptimin të masave alternative
nga viti 2005-2010**